



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 30.6.2026, e cila filloi në orën 14:16.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, (Lidhja për Prishtinën), kryesues i Kuvendit, Bekim Gashi (LDK), Fadil Aliu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Egzon Pacolli (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Etnik Mustafa (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Dhurata Jahaj Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi Osmani (LDK), Rifadije Sopi (LDK), Amir Simnica (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Agron Canolli (PDK), Agnesa Avdyli Vitia (PDK), Elmi Fazliu (PDK), Yll Muriqi (PDK), Muhamet Ademi (PDK), Plator Gërdovci (PDK), Florian Beka (PDK), Kumrije Shabani Ramadani (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fjolla Vukshinaj Reçica (PDK), Trim Sylja (PDK), Mrika Limani Myrtaj (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Jeta Dida Bujari (LVV), Berita Abazi Muhadri (LVV), Feim Osmani (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Nexhmije Gjema (LVV), Lumnije Mikullovc (LVV), Leonora Shabani Bajraktari (LVV), Enver Redenica (LVV), Kreshnik Smajlaj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Erblina Tahiraj (AAK), Teuta Kadiu Gjinolli (Lidhja e Prishtinës), Besa Shahini (PSD), Endrit Zabërgja (NISMA), Jeton Mehmeti (GUXO), Valbona Ajeti (e pavarur), Yll Bogaj (i pavarur), Betim Abdullahu (i pavarur).

Munguan: Donjeta Dragusha (LDK), Ilirik Musliu (PDK), Çlirim Gërbeshi (LVV), Arbentia Murseli Haxholli (Lidhja e Prishtinës).

Të pranishëm ishin edhe: Florian Dushi, nënkryetar i Komunës, Besianë Musmurati, nënkryetare e Komunës, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Zyhrije Pllana, drejtore e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, Leutrim Retkoceri, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Gent Begolli, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave, Driton Bardheci, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Arianit Elshani, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Albana Gjonbalaj, drejtore e Drejtorisë së Parqeve, Jeta Rafuna Hasani, drejtore e Drejtorisë së Bujqësisë, Adelinë Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Granit Geci, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Pëllumb Bajçinovci, drejtor i Drejtorisë së Mobilitetit, Donat Gashi, drejtor i Drejtorisë së Rinisë, Isah Mustafa, drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Rrezarta Aliu, drejtore e Drejtorisë së Turizmit, Bekim Brestovci, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të KFOR-it dhe të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit, i cili tha se për këtë mbledhje është paraparë ky

Rend i ditës:

- 1. Propozim-vendimi për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2027-2029 (KAB);**
- 2. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL "Prishtina Parking";**
- 3. Propozim-vendimi për emërimin e aksionarëve: Kompania rajonale e mbeturinave "Pastrimi", SHA; Ndërmarrja Publike Banësore, SHA; Ndërmarrja Publike "Gjelbër" SHA; Ndërmarrja Publike "Prishtina Parking", SHA.**

Rifadije Sopi tha se mundet të ketë rrjedh ndonjë gabim teknik dhe mendoj se duhet me e shtu plotësim-ndryshimin për Ndërmarrjen "Sport Marketing" për zgjedhjen e aksionarëve.

Kryesuesi vazhdoni me pikën e parë të rendit të ditës.

- 1. Propozim- vendimi për miratimin e Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2027-2029 (KAB).**

Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, theksoi se Korniza afatmesme buxhetore (KAB) 2027–2029, është dokumenti kryesor strategjik dhe financiar i Kryeqytetit, i hartuar në përputhje me procedurat buxhetore të Ministrisë së Financave dhe legjislacionin në fuqi. Ajo tha se KAB përcakton prioritetet zhvillimore, kufijtë e shpenzimeve dhe objektivat financiare për periudhën trevjeçare, duke synuar rritjen e efikasitetit në menaxhimin e buxhetit, përmirësimin e mbledhjes së të hyrave vetanake, ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe avancimin e shërbimeve për qytetarët përmes digjitalizimit. Ajo bëri të ditur se për vitin 2027, buxheti i planifikuar i Kryeqytetit arrin në **161,095,638 euro**, i përbërë nga granti i përgjithshëm, grantet specifike për Arsim dhe Shëndetësi, si dhe nga Ligji për Kryeqytetin, dhe **44,173,910 euro** të hyra vetanake. Këto mjete janë planifikuar të shpërndahen sipas prioritetëve dhe projekteve të secilës drejtori, me synim realizimin e investimeve dhe përmirësimin e shërbimeve publike gjatë periudhës 2027–2029.

Kryesuesi hapi diskutimin.

Egzon Pacolli u sshpreh në përkrahje të Propozim-vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për miratimin e Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2027-2029 të KAB-së.

Fjolla Vukshinaj Reçica deklarohet në emër të Grupit të asamblistëve të Partisë Demokratike të Kosovës, se e vlerësojnë punën që është bërë në hartimin e Kornizës afatmesme buxhetore 2027–2029, ai është një dokument më i detajuar dhe më i strukturuar krahasuar me vitet e kaluara, duke reflektuar në rekomandimet e Ministrisë së Financave dhe një planifikim më të qartë të të hyrave komunale. Fjolla theksoi se rritja e planifikuar e të hyrave është një zhvillim pozitiv, por suksesi i Komunës duhet të matet edhe me cilësinë e shërbimeve që u ofrohen qytetarëve, përmes një administrate profesionale, efikase dhe të orientuar drejt nevojave të tyre. Ajo paraqiti disa sugjerime konkrete për përmirësimin e dokumentit, veçanërisht në Drejtorinë e Mobilitetit, ku përmendi investimet në infrastrukturën e transportit publik, me pritore moderne të autobusëve, zgjerim të rrjetit të korsive për biçikleta. Njëherësh kërkoi një qasje më ambicioze në politikat për rininë, përfshirë transformimin e Pallatit të Rinisë dhe mbështetjen më të madhe për punësimin e të rinjve. Pastaj ceku rëndësinë e subvencioneve, ku përmes tyre mbështetet bujqësia, arsimi,

kultura, sporti, shëndetësia e shumë iniciativa që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së qytetarëve. Kërkoj harmonizimin e Kornizës me Strategjitë zhvillimore të Kryeqytetit dhe zhvillimin e konsultimeve publike me qytetarë. Ajo në përfundim, tha se Grupi i PDK-së e mbështetet miratimin e Kornizës afatmesme buxhetore, me pritjen që sugjerimet e paraqitura të reflektohen në hartimin e buxhetit përfundimtar për vitin 2027.

Feim Osmani vlerësoi se Korniza afatmesme buxhetore 2027–2029, nuk paraqet një dokument strategjik me vizion zhvillimor, por një planifikim që, sipas tij, ndjek trendet ekzistuese pa ambicie për rritjen e të hyrave vetanake dhe zhvillimin e Kryeqytetit. Ai theksoi se buxheti mbështetet kryesisht në grandet qeveritare, ndërsa pjesëmarrja e të hyrave vetanake mbetet e ulët, po ashtu, ngriti shqetësime për strukturën e shpenzimeve, duke vlerësuar se pesha e investimeve kapitale është e pamjaftueshme në raport me kategoritë rrjedhëse të shpenzimeve dhe se projektet e planifikuara nuk reflektojnë një strategji afatgjatë zhvillimore. Osmani kritikoi shpërndarjen e investimeve kapitale, duke theksuar se zonat rurale, sipas tij, janë të nënfinancuara krahasuar me zonat urbane. Ai vlerësoi se një pjesë e projekteve të përfshira janë përsëritje të premtimeve të mëhershme ose nuk kanë financim të mjaftueshëm për t'u realizuar. Gjithashtu, ngriti shqetësime për kohën e procedimit të dokumentit, duke vlerësuar se ai është sjellë në afatin e fundit ligjor, çka kufizon mundësinë për shqyrtim dhe përmirësim. Ai kërkoj sqarime lidhur me investimet në arsim, financimin e shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve dhe blerjen e mekanizmit për mbjelljen e drurëve. Osmani deklaroi se edhe pse kemi vërejtjet tona, ne do ta mbështesim Kornizën afatmesme buxhetore me votë, me pritjen që vërejtjet e paraqitura të adresohen në procesin e hartimit të buxheteve vjetore.

Besa Shahini shprehu mendimin se ky dokument nxjerr në pah tri shqetësime kryesore; së pari, investimet në arsim janë të pamjaftueshme për të zgjidhur problemin e shkollave të cilat e zhvillojnë mësimin me gjysmë orari, duke lënë nxënësit e Prishtinës katër vite mbrapa krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre nëpër kryeqytete tjera. Shqetësimi i dytë është se projekti i sheshit po vazhdon të marr një pjesë të madhe të buxhetit, ndonëse nuk konsiderohet prioritet për qytetarët dhe është shoqëruar me gjetje kritike të auditorit dhe, çështja e tretë, është raporti i auditorit, i cili evidenton se miliona euro po shpenzohen për përmbarim, për shkak të keqplanifikimit buxhetor, duke dëmtuar financat e Komunës, ku në tërësi dokumenti kritikon prioritetet buxhetore dhe mënyrën e menaxhimit të financave komunale.

Endrit Zabërgja e vlerësoi punën profesionale të drejtoreshës dhe ekzekutivit për përpilimin e Kornizës afatmesme buxhetore (KAB), dhe kujtoi se ky dokument nuk duhet të mbesë vetëm shifra në letër, por do të monitorohet hap pas hapi për secilin projekt kapital, si në arsim, shëndetësi, administratë, shërbime publike dhe projekte të cilat janë të domosdoshme. Ai kërkoj nga ekzekutivi që në tri vitet e ardhshme rinia të mos trajtohet thjesht si "investim kapital", por si investim njerëzor përmes projekteve të rivitalizimit institucional. Njëherësh kërkoj që në dokumentet e radhës strategjike, siç është buxheti i vitit 2027, ndarja e prioritetëve të reflektojë në mënyrë të barabartë nevojat e të gjithë qytetarëve. Zabërgja ofroi mbështetjen e tij për këtë dokument, duke iu dëshiruar punë të mbarë në realizimin e projekteve.

Fiknete Bejta u shpreh se Korniza afatmesme buxhetore 2027–2029 është dokumenti kryesor strategjik që përcakton drejtimin e zhvillimit të Komunës së Prishtinës për tri vitet e ardhshme. Ajo deklaroi se ka rritje të buxhetit nga 161 milionë euro në vitin 2027, në 175 milionë euro në

vitin 2029, duke krijuar më shumë hapësirë për investime në infrastrukturë, arsim, shëndetësi, hapësira të gjelbra, kulturë, sport dhe transformim digjital. Ajo tha se dokumenti mbështetet jo vetëm në grandet qeveritare, por edhe në rritjen e të hyrave vetanake përmes administrimit më efikas financiar, duke forcuar qëndrueshmërinë fiskale të Komunës. Ajo vendos theks të veçantë në transparencë, planifikim afatgjatë dhe përfshirjen e qytetarëve përmes dëgjimeve publike, ku miratimi me kohë i kësaj kornize është thelbësor për të shmangur vonesat në realizimin e projekteve dhe kostot shtesë për Komunën, duke siguruar vazhdimësi në investime dhe shërbime më cilësore për qytetarët e Prishtinës.

Gëzim Sveçla kritikoi mënyrën se si dokumenti u soll për shqyrtim vetëm pak orë para skadimit të afatit ligjor, si dhe mungesën e kryetarit Përparim Rama dhe zyrtarit më të lartë financiar të komunës. Sipas tij, kjo dëshmon papërgjegjësi institucionale dhe keqmenaxhim, të konfirmuar edhe nga raporti i fundit i auditimit. Ai theksoi se rritja e buxhetit të Prishtinës vjen kryesisht nga fondet e siguruara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, duke argumentuar se për çdo 1 euro shtesë të mbledhur nga Komuna përmes të hyrave vetanake, qeveria ka sjellë rreth 4.5 euro për kryeqytetin. Sveçla shtoi se kjo dëshmon se Prishtina mbetet prioritet për nivelin qendror, por kritikoi planifikimin e 3.5 milionë eurove për zgjatjen e sheshit "Xhorxh Bush" deri te Rrethi me Flamur, ndërkohë që çështjet ligjore dhe gjetjet e auditimit për këtë projekt ende nuk janë përmbyllur. Ai ngriti shqetësim edhe për mungesën e dëgjimeve publike gjatë hartimit të Kornizës buxhetore.

Jeta Dida Bujari ngriti shqetësime për zbatimin e projekteve në fushën e arsimit dhe kulturës, duke theksuar se rritja e buxhetit nuk ka vlerë pa realizim konkret në terren. Ajo kërkoi që ndërtimi i Liceut artistik për Shkollën e mesme të lartë "Prek Jakova", të trajtohet si prioritet, pasi nxënësit dhe stafi vazhdojnë të zhvillojnë mësimin në kushte të papërshtatshme. Ajo kritikoi gjithashtu menaxhimin e projektit "Ishulli urban", duke theksuar se punimet u ndërprejnë për shkak të mungesës së lejeve dhe procedurave ligjore, duke rrezikuar edhe realizimin e projektit të Teatrit të Operës dhe Baletit, dhe kërkoi sqarime dhe afate konkrete nga ekzekutivi komunal për zgjidhjen e këtyre çështjeve dhe fillimin e projekteve të planifikuara.

Nexhmije Gjema kritikoi mungesën e arsytimit teknik dhe transparencës në listën e investimeve kapitale të Kornizës afatmesme buxhetore. Ajo vuri në pikëpyetje projektin për zgjerimin e sheshit "Xhorxh Bush" deri te Rrethi me Flamur, duke kërkuar sqarime mbi logjikën dhe përfitimet e investimit, si dhe duke e krahasuar sipërfaqen e shesheve në Prishtinë me atë të Londrës. Në vazhdim ngriti shqetësime për mungesën e projektit të varrezave të kryeqytetit në planifikim, ndarjen e 1 milion eurove për programin "Kontrata në shtëpi" dhe buxhetin e kufizuar për personat me nevoja të veçanta. Në fund, ajo theksoi se nuk është kundër miratimit të Kornizës afatmesme Buxhetore, por kërkoi më shumë transparencë, argumentim profesional dhe informacione të detajuara për secilin projekt, në mënyrë që shpenzimi i parasë publike të jetë i arsytuar dhe i besueshëm.

Leonora Shabani shprehu shqetësimin për planifikimin e ndërtimit të vetëm dy çerdheve gjatë tri viteve të ardhshme, duke vlerësuar se si kryeqytet, Prishtina duhet të investojë më shumë në zgjerimin e kapaciteteve për kujdesin ndaj fëmijëve. Ajo ngriti gjithashtu çështjen e mbrojtjes së fëmijëve, duke theksuar mungesën e një qendre për strehimin dhe mbrojtjen e tyre në Prishtinë, si

dhe kërkoi sqarime për investimet e parapara në këtë fushë, dhe bëri thirrje që mirëqenia e fëmijëve të trajtohet si prioritet në planifikimin buxhetor.

Valbona Makolli sqaroi se objektivat e Kornizës afatmesme buxhetore duhet të jenë në përputhje me Qarkoren buxhetore dhe grantet e përcaktuara nga niveli qendror, pasi kjo është kërkesë ligjore për të gjitha komunat. Ajo ftoi asamblistët dhe qytetarët të marrin pjesë në dëgjimet buxhetore për të kontribuar në hartimin e buxhetit. Makolli tha financimi i investimeve në çerdhe dhe shkolla, realizohet nga Ministria e Arsimit, ndërsa përgjegjësia e Komunës është sigurimi dhe miratimi i lokacioneve për ndërtim dhe projektet nuk janë lënë pas dore, por janë në proces përgatitjeje dhe procedurash.

Feim Osmani vlerësoi se Korniza afatmesme buxhetore është dokumenti më i rëndësishëm strategjik dhe financiar i Komunës dhe meriton debat më të gjerë. Ai tha se disa nga pyetjet e ngritura nuk morën përgjigje, përveç atyre që lidhen me çerdhet dhe shkollat. Osmani kërkoi sqarime për disa zëra të planifikuar në buxhet, si financimi i shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve dhe blerja e mekanizmit për mbjelljen, transportin dhe vendosjen e drurëve të mëdhenj, duke pyetur nëse kjo pajisje do të përdoret nga Komuna apo nga një ndërmarrje publike. Ai theksoi nevojën për shpjegime më të qarta dhe më të detajuara nga drejtoritë përgjegjëse.

Betim Abdullahu tha se Korniza afatmesme buxhetore nuk parasheh asnjë investim për fshatrat Vranidoll, Rimanishtë dhe Teneshdoll, gjatë tri viteve të ardhshme dhe për këtë arsye, ai u deklarua se nuk mund ta votojë dokumentin.

Kryesuesi konstatoi se Propozim-vendimi për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2027-2029 (KAB), u miratua me dyzet e një vota për, dy kundër, asnjë abstenim.

Pika e dytë e rendit të ditës

Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL "Prishtina Parking"

Florian Dushi, nënkryetar - kërkoi miratimin e ndarjes së 100 mijë eurove nga kategoria e subvencioneve për ndërmarrjen "Prishtina Parking", duke sqaruar se ndërmarrja po përballet me vështirësi financiare pas ndryshimeve të imponuara nga vendimi i Gjykatës Supreme. Ai theksoi se mbështetja financiare është e nevojshme për të siguruar funksionimin e ndërmarrjes deri në miratimin e rregullores së re, e cila pritet të garantojë stabilitetin e saj financiar.

Valbona Makolli sqaroi se subvencioni në vlerë prej 100 mijë eurosh, do të ndahet nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve të administratës, duke theksuar se ky klasifikim duhet të korrigjohet në dokumentacionin e Kuvendit, nëse nuk është pasqyruar saktë.

Egzon Pacolli u shpreh në mbështetje të subvencionimit të ndërmarrjes "Prishtina Parking".

Trim Syla deklaroi, në emër të PDK-së, se e përkrahin subvencionimin e ndërmarrjes "Prishtina Parking".

Nora Kelmendi ngriti shqetësime serioze lidhur me propozim-vendimin për ndarjen e 100 mijë eurove për ndërmarrjen publike "Prishtina Parking", duke theksuar se dokumenti i paraqitur para Kuvendit të Komunës nuk përmbante arsyetim, shumën e specifikuar, burimin e financimit dhe dokumentacionin e nevojshëm ligjor. Ajo tha se mungesa e këtyre elementeve e bën të pamundur një vendimmarrje të saktë dhe transparente. Kuvendi i Komunës nuk duhet të shndërrohet në mekanizëm për mbulimin e pasojave të keqmenaxhimit, por të kërkojë përgjegjësi, transparencë dhe respektim të procedurave ligjore. Kelmendi kërkoi që çdo mbështetje financiare për ndërmarrjen të kushtëzohet me auditim të pavarur, plan të rimëkëmbjes financiare, ristrukturim dhe reforma konkrete, duke vlerësuar se vetëm në këtë mënyrë mund të mbrohet interesi i qytetarëve dhe të sigurohet menaxhim i përgjegjshëm i parasë publike.

Teuta Kadiu Gjinolli përkrahu mbështetjen e propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për ndërmarrjen "Prishtina Parking", duke theksuar se ndërmarrja dhe punëtorët e saj kanë nevojë për mbështetje.

Besa Shahini shprehu mirëkuptim për nevojën e mbështetjes së ndërmarrjes, por theksoi se nuk mund ta votojë vendimin pa dokumentacionin dhe arsyetimet e nevojshme. Ajo kërkoi që materialet për shqyrtim të dërgohen me kohë dhe të jenë të kompletuara për të mundësuar vendimmarrje të informuar.

Endrit Zabërgja theksoi se çështja e ndërmarrjes "Prishtina Parking" kërkon zgjidhje dhe jo vetëm debat politik. Ai vlerësoi se, mbështetja financiare është e domosdoshme për tejkalimin e krizës dhe vazhdimin e shërbimeve për qytetarët, pavarësisht kritikave ndaj menaxhimit të ndërmarrjes. Zabërgja përkrah subvencionin, duke shpresuar që me rregulloren e re, aksionarët dhe menaxhmentin e ri, ndërmarrja të funksionalizohet dhe të shndërrohet në një prej ndërmarrjeve më të fuqishme të kryeqytetit.

Kushtrim Sopa theksoi rëndësinë e mbështetjes së ndërmarrjes "Prishtina Parking", duke rikujtuar se kjo ndërmarrje ka nisur me vetëm tre punëtorë, dhe sot numëron rreth 200. Ai vlerësoi iniciativën e Komunës së Prishtinës për të ndihmuar pas vendimit të Gjykatës Supreme, por theksoi se mbështetja aktuale nuk mbulon as 70 % të pagës mujore të punëtorëve. Sopa përmendi borxhin e akumuluar prej rreth 1 milion euro dhe kërkoi angazhim të përbashkët, përtej dallimeve politike, për rikthimin e kapaciteteve të plota të ndërmarrjes "Prishtina Parking", miratimin e rregullores së re dhe zgjerimin e operimit të ndërmarrjes, me synim edhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Enver Redenica kritikoi mungesën e mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe kërkoi më shumë transparencë e llogaridhënie nga ekzekutivi komunal. Ai theksoi se për ndërmarrjen "Prishtina Parking" nuk duhet të lejohet falimentimi dhe se punëtorët nuk duhet të mbeten pa punë, por kërkoi një raport të detajuar për shkaqet që e kanë sjellë ndërmarrjen në krizë financiare. Redenica vuri në pikëpyetje menaxhimin e mëparshëm të ndërmarrjes, duke kërkuar që para ndarjes së mjeteve publike, të ketë sqarime për destinimin e subvencionimit dhe përgjegjësi për keqmenaxhiment e mundshme. Ai kërkoi hetim të plotë dhe transparencë, duke theksuar se qytetarët presin mbrojtjen e interesit publik dhe përdorimin e përgjegjshëm të parasë publike.

Feim Osmani shprehu shqetësim të thellë për gjendjen e ndërmarrjes “Prishtina Parking”, duke theksuar se problemi nuk është vetëm kërkesa për 100,000 euro mbështetje financiare, por arsyet që e kanë sjellë ndërmarrjen në këtë situatë. Ai kritikoi mungesën e kryetarit në seancë, duke vlerësuar se mungojnë sqarimet nga personi përgjegjës për zhvillimet në ndërmarrje. Sipas Osmanit, një ndërmarrje me klientelë të garantuar dhe me mbi 2 milionë euro qarkullim në vitin 2024, nuk do të duhej të përballej me vështirësi të tilla financiare. Ai ngriti gjithashtu shqetësimin se vendimi i gjykatës për rregulloren nuk është trajtuar në Kuvend me kohë, gjë që, sipas tij, ka ndikuar në përkeqësimin e gjendjes, dhe kërkoi sqarime të plota për gjendjen financiare të ndërmarrjes, përdorimin e mjeteve të kërkuara dhe planin për të ardhmen.

Valbona Makolli kërkoi që pika e rendit të ditës të tërhiqej nga shqyrtimi, duke arsyetuar se kjo vjen si pasojë e problemeve teknike. Ajo propozoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e rregullt të radhës.

Besart Krasniqi ngriti shqetësime lidhur me kërkesën për subvencionim prej 100,000 eurosh për ndërmarrjen “Prishtina Parking”, duke vënë në pikëpyetje se si një ndërmarrje e prezantuar vazhdimisht si e suksesshme ka nevojë për mbështetje financiare nga buxheti publik. Ai kërkoi sqarime për qëndrueshmërinë financiare të ndërmarrjes dhe arsyet pse ajo nuk arrin të mbulojë shpenzimet nga të hyrat e veta, dhe kërkoi përgjigje lidhur me gjobat e shqiptuara, të cilat pas vendimit të Gjykatës Supreme janë konsideruar të jashtëligjshme, duke pyetur nëse qytetarëve do t’u kthehen mjetet e paguara. Krasniqi në fund pyeti se a planifikohet zgjerimi i veprimtarisë së ndërmarrjes në lagje të tjera të Prishtinës dhe a parashihen investime në ndërtimin e hapësirave të reja të parkimit për banorët.

Gëzim Sveçla e kundërshtoi kërkesën për subvencionimin e ndërmarrjes “Prishtina Parking”, duke argumentuar se një ndërmarrje me monopol, pa konkurrencë dhe me klientelë të garantuar nuk duhet të mbështetet financiarisht nga buxheti i Komunës. Ai tha se gjendja aktuale është pasojë e keqmenaxhimit dhe jo e kushteve të tregut, dhe kritikoi mënyrën e menaxhimit të ndërmarrjeve publike, duke pretenduar se ato janë përdorur për punësime politike, favorizim të donatorëve dhe mungesë llogaridhënieje. Sveçla ngriti gjithashtu shqetësime për zhvendosjen e zyrave në ambiente private me qira, mosveprimin pas aktgjykimit të Gjykatës Supreme për rregulloren, si dhe pretendime për parregullsi në funksionimin e ndërmarrjes. Ai kërkoi transparencë dhe përgjegjësi për menaxhimin e ndërmarrjes, duke kundërshtuar ndarjen e mjeteve publike pa një arsyetim të qartë.

Bekim Gashi mbrojti kërkesën për mbështetje financiare ndaj ndërmarrjes “Prishtina Parking”, duke argumentuar se edhe Qeveria e Kosovës ka subvencionuar ndërmarrje publike në nivel qendror. Ai kritikoi opozitën me akuzuar për korrupsion dhe keqpërdorime, duke kundërshtuar, sipas tij, pretendimet për mungesë morali në debat, dhe rikujtoi se ishte kërkuar të tërhiqej pika nga rendi i ditës dhe shprehu mbështetjen për këtë propozim.

Egzon Pacolli reagoi ndaj deklaratave të parafolësit, duke i kundërshtuar akuzat e adresuara ndaj subjektit të tij politik. Ai deklaroi se çdo pretendim për keqpërdorime duhet të dërgohet në organet e drejtësisë dhe solli shembuj të rasteve që, sipas tij, janë trajtuar nga prokuroria. Pacolli gjatë debatit u përqendrua në akuza politike reciproke dhe jo në shqyrtimin e kërkesës për mbështetje financiare për ndërmarrjen “Prishtina Parking”.

Berita Abazi kritikoi devijimin e debatit nga tema e rendit të ditës, duke theksuar se diskutimi duhet të përqendrohet te çështja e ndërmarrjes “Prishtina Parking” dhe jo te zhvillimet në nivel qendror. Ajo shprehu shqetësim për mungesën e dokumentacionit që arsyeton kërkesën për 100,000 euro mbështetje financiare dhe kërkoi më shumë transparencë lidhur me destinimin e këtyre mjeteve, dhe kundërshtoi kërkesën për tërheqjen e pikës nga rendi i ditës, duke u mbështetur në ligjet dhe rregulloren me të cilën funksionon Kuvendi dhe pasi debati kishte avancuar.

Bekim Brestovci dha sqarime lidhur me procedurën e shqiptimit të gjobave nga “Prishtina Parking”, duke kundërshtuar pretendimet për falsifikim. Ai shpjegoi se punëtori i ndërmarrjes vetëm e bënë identifikimin e shkeljeve dhe ia përcjellin rastet inspektoratit, ndërsa vendimi për shqiptimin e gjobës merret nga inspektori kompetent dhe punëtori i ndërmarrjes “Prishtina Parking” vetëm e dorëzon njoftimin për gjobën në automjet, në kuadër të procedurës së paraparë me marrëveshjen ndërmjet ndërmarrjes dhe inspektoratit.

Gëzim Sveçla ngriti shqetësime lidhur me procedurën e shqiptimit të gjobave, duke pretenduar se në disa raste ato janë lëshuar nga persona që nuk janë inspektorë komunalë dhe kërkoi që procedurat ligjore të respektohen.

Feim Osmani tha se, sipas sqarimit të drejtorit, inspektori nuk del në vendin e ngjarjes për ta konstatuar shkeljen, por gjoba lëshohet në mënyrë elektronike, bazuar në raportin e punëtorit të ndërmarrjes “Prishtina Parking”.

Bekim Brestovci sqaroi se për shkeljet në hapësirat e gjelbëruara dhe parkingjet komunale, gjobat shqiptohen nga inspektorët në terren, ndërsa në hapësirat e “Prishtina Parking” shkeljet evidentohen nga punëtorët e ndërmarrjes dhe gjobat miratohen në mënyrë digjitale nga Inspektorati, sipas marrëveshjes ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe “Prishtina Parking”.

Kryesuesi konstatoi se Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL “Prishtina Parking”, me nëntë vota për, katërmëdhjetë kundër, asnjë abstenim, nuk u miratua.

Pika e tretë e rendit të ditës

Propozim-vendimi për emërimin e aksionarëve: Kompania rajonale e mbeturinave “Pastrimi”, SHA; Ndërmarrja publike banesore, SHA; Ndërmarrja publike “Gjelbër” SHA; Ndërmarrja publike “Prishtina Parking”, SHA, Ndërmarrja publike “ Sport Marketing” SHA.

Agnesa Avdyli Vitija i propozoi emrat e aksionarëve për ndërmarrejt publike, si në vijim:

- Ndërmarrja Publike Banesore: Fjolla Vukshinaj Reçica dhe Elmi Fazliu;
- Ndërmarrja “Prishtina Parking”: Yll Muriqi dhe Muhamet Ademi;
- Ndërmarrja publike lokale “Gjelbër”: Kumrie Shabani Ramadani dhe Plator Gërdovci;
- Kompania rajonale e mbeturinave: “Pastrimi”: Hana Bajrami Rexhepi dhe Sefedin Sefaj.

Rifadije Sopi i njoftoi për një plotësim-ndryshim në ndërmarrjen publike “Sport Marketing”, pasi që nuk ka ndodhur një gabim teknik, ku në vend të z. Driton Rukiqi, emërohet z. Astrit Gashi dhe në vend të z. Pëllumb Bajçinovci shkon z. Faton Pacolli.

Kryesuesi njoftoi se kjo nuk është pikë e rendit të ditës, por është vetëm plotësim-ndryshim.

Gëzim Sveçla tha se propozimi i fundit nuk ishte pjesë e materialeve të shpërndara dhe se në një seancë të jashtëzakonshme nuk mund të ndryshohet rendi i ditës. Ai u uroi punë të mbarë aksionarëve të rinj, duke theksuar se emërimi i tyre është e drejtë legjitime e shumicës. Sveçla shprehu shpresën që të mos përsëriten problemet e mandatit të kaluar, duke vlerësuar se gjendja e disa ndërmarrjeve dhe kërkesat e tyre për subvencione janë pasojë e mungesës së kontrollit nga aksionarët. Ai bëri thirrje që aksionarët e rinj të angazhohen për t'i shërbyer qytetarëve dhe që ndërmarrjet të mos bëhen barrë për Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi propozoi që emërimi i aksionarëve në ndërmarrjet publike të votohej në paketë. U prezantuan kandidatët për Kompaninë Rajonale të Mbeturinave “Pastrimi”, Ndërmarrjen Publike Banesore, Ndërmarrjen Publike “Gjelbër” dhe Ndërmarrjen Publike “Prishtina Parking”, ndërsa emërimi i aksionarëve për “Sport Marketing” u shty për seancën e rregullt.

Kryesuesi konstatoi se Propozim-vendimi për emërimin e aksionarëve: Kompania rajonale e mbeturinave “Pastrimi”, SHA; Ndërmarrja Publike banesore, SHA; Ndërmarrja Publike “Gjelbër”, SHA; Ndërmarrja publike “Prishtina Parking”, SHA, miratohet me njëzetë e nëntë vota për, një kundër, asnjë abstenim.

Mbledhja përfundoi në orën 16:01.

Procesmbajtësi
Skender Tora

Kryesues i Kuvendit
Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



TRANSKRIPT

i mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit, mbajtur me 30.6.2026 duke filluar në orën 14:00

Kryesuesi: - Përshëndetje të gjithëve! Të nderuar anëtar të Kuvendit të Kryeqytetit! Të nderuar nënkryetar, drejtor të drejtorive, përfaqësues të mediave dhe të gjithë ju që jeni prezent, mirë se erdhët në këtë seancë të jashtëzakonshme, ju përshëndes dhe ju faleminderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë seancë. Në bazë të dispozitave ligjore për Vetëqeverisjen Lokale statusit të Komunës së Prishtinës, dhe Udhëzimit administrativ për mbajtjen e mbledhjes së kuvendit me iniciativën e kryetarit të kryeqytetit z. Rama, sot kemi thirrur këtë seancë të jashtëzakonshme në të cilat do të shqyrtohen pikat e rendit të ditës, materialet të cilat i keni pranuar me kohë së bashku me ftesat lidhur me këtë seancë. Para se të fillojmë shqyrtojmë pikat e rendit të ditës, do të bëjmë evidentimin e pjesëmarrjes së anëtarëve të Kuvendit këtu, lus shërbimin e kuvendit që të konstatoj së e kemi kuorum për mbajtjen e kësaj mbledhje? 44 anëtarë janë prezentë faleminderit. Pasi që është konstatuar kuorumi po fillojmë me mbledhjen. Sot janë paraparë 3 pika të rendit të ditës:

- 1. Propozim- vendimi për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2027-2029 (KAB);**
- 2. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL "Prishtina Parking";**
- 3. Propozim-vendimi për emërimin e aksionarëve: Kompania rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SH.A; "Ndërmarrja Publike Banesore", SH.A; Ndërmarrja Publike "Gjelbërt", SH.A; Ndërmarrja Publike " Prishtina Parking", SH.A.**

A ka dikush ndonjë propozim? Rifadije Sopi, urdhëro Rifadije.

Rifadije Sopi: - faleminderit kryesues. Mendoj që mundet të ketë rrjedh ndonjë gabim teknik dhe mendoj që duhet me e shtuar plotësim ndryshimin për Ndërmarrjen "Sport Marketing".

Kryesuesi: - faleminderit, atëherë edhe për Ndërmarrjen "Sport Marketing" për aksionar a po. Po, faleminderit . Atëherë po vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Propozim- vendimi për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2027-2029 (KAB); Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës fjalën për këtë pikë ia dha drejtoreshës znj. Makolli fjala për juve drejtoreshë .

Valbona Makolli: - faleminderit kryesues. Përshëndetje kryesues, përshëndetje për të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal, dhe ju të pranishëm në sallë. Kam kënaqësinë të paraqes dokumentin bazë më të rëndësishëm të kryeqytetit kornizën afatmesëm buxhetore për periudhën 2027-2029, siç e ceka më lartë KAB, apo korniza afatmesme buxhetore është një ndër dokumentet bazë. Në bazë të secilës shihet strategjia dhe zhvillimi i kryeqytetit për këtë periudhë kohore. Korniza afatmesme buxhetore është e përpiluar në përputhje me procedurat buxhetore të 2027-2029 të dhëna nga Ministria e Financave përmes qarkores buxhetore 2027 01 për komuna si dhe për nivelet e tjera qeveritare. Korniza afatmesme buxhetore është e bazuar edhe në ligjet të cilat duhet të mirrën parasysh para aprovimit të saj, është ligji për financat e pushtetit lokal, ligji për menaxhimin financave publike dhe përgjegjësi, ligji për Vetëqeverisjen Lokale dhe ligji për kufit administrativ komunal. Korniza afatmesme buxhetore përmban të gjitha objektivat e komunës së Prishtinës për këtë periudhë e cila përputhet po ashtu me objektivat e qeveris të Kosovës, si dhe përcakton të gjitha limitet e shpenzimeve buxhetore sipas planifikimeve pas dëgjimeve buxhetore dhe pas pranimi të qarkores së dytë nga Ministria e Financave. Objektivat kryesore të kornizave afatmesëm bugjetore është shtimi i efikasitetit në shpenzimet buxhetore komunale, shfrytëzimi maksimal i këtyre burimeve, respektimi i afateve kohor gjatë periudhës 3-vjeçare po ashtu rendësi shumë të madhe ka rritja e efikasitetit në vjeljen e të hyrave vetanake të përcaktuar në këtë qarkore dhe zbatimin dhe mundësin e zbatimit të tarifave të reja duke u bazuar në rregulloren për kryeqytetin. Rëndësi, jo më të vogël kanë edhe ngritja e kapaciteteve njerëzore që do të thotë trajnimi i burimeve dhe respektive njerëzore, po ashtu përdorimi i Software të avancuar për shërbime ndaj qytetarëve dhe profesionalizimi i këtyre shpenzimeve. Për mos me ju marr shumë kohë, meqenëse materialin e keni marrë dhe është shumë zgjerimisht dhe është koha për me ju dëgju juve, shkurtimisht po ju lajmëroj që për periudhën 2027 sipas komisionit të grandit të caktuara nga qeveria e Kosovës, kryeqyteti do t'i takojnë 161 milion e 95,638 të ndara në këtë mënyrë. Grandi i përgjithshëm për kryeqytetin është 52 milion 690,420. Grandi specifik i arsimit 31 milion e 801,112. Grandi specifik për shëndetësinë 10 milion 204508. Ligji për kryeqytetin është 22 milion 250688 dhe të hyrat vetanake që kryeqyteti i ka për obligim t'i mbledh për vitin 2027 ka rritur vlerën prej 44 milion e 173910. Këto të hyra vetanake siç e dini janë të shpërndara në 2 forma. Është tatimi mbi pronë të hyrat nga tatimi në pronë që për vitin 2027 është 16 milion 64156 dhe pjesa tjetër prej 27.532.405 milion euro do të jenë taksa, ngarkesa dhe të hyra tjera komunale, e që në total bëjnë 44 milion 173.910, që do të shpërndahen nëpër projekte të ndryshme të cilat janë të paraqitur për secilën drejtori veç e veç. Tabelat janë të paraqitura sipas drejtorive çka vlen të theksohet se Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Drejtoria e Transformimeve janë në një tabelë, arsyen veç e kam dhënë sqarimin për ju dhe për qytetarët si Drejtoria e Investimeve Kapitale do të menaxhon, mbikëqyrë ndërtimet e ulëta në bashkëpunim me drejtoritë përkatës dhe kërkesat e qytetarëve, kurse drejtoria transformimi menaxhon dhe mbikëqyr ndërtesat e larta domethënë objektet normal në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse ku veç janë të prezantuara nëpër secilën drejtori veç e

veç. Kaq kisha, shumë shkurt për mos me ju marrë kohë, atëherë po ju lë në dispozicion. Faleminderit për vëmendjen të gjithëve.

Kryesuesi: - faleminderit drejtoreshë. Hapi diskutimin. Shkojmë me shefat e grupeve nga LDK, z. Egzon Pacolli.

Egzon Pacolli:- faleminderit kryesues, të nderuar asambleistë, i nderuar nënkryetarë, të nderuar qytetarë. Ne e përkrahim propozim-vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2027-2029 të KAB.

Kryesuesi:- faleminderit z. Pacolli. Në radhët e PDK-së Fjolla Vukshinaj-Reçica.

Fjolla Vukshinaj - Reçica: - faleminderit kryesues. Të nderuar nënkryetarë, drejtorë, kolegë të nderuar asambleistë. Unë kam me qenë pak më e gjatë sesa kolegu Pacolli kështu që bëmani hallall. Edhe e kam shkruar një fjalim që është për herë të parë. Sot kemi para vetes kornizën afatmesme buxhetore një dokument që i paraprin buxhetit të vitit 2027 dhe përcakton orientimin zhvillimor të kryeqytetit për vitet në vijim. Prandaj nuk është vetëm një dokument financiar, por një dokument politik sepse tregon ku duhet ta çojmë Prishtinën. Në emër të grupit të asamblistëve të Partisë Demokratike të Kosovës, dua të them se e vlerësojmë punën që është bërë në përgatitjen e këtij dokumenti. Korniza është më e detajuar sesa në vitet e kaluara. Është më e qartë në paraqitjen e të hyrave dhe reflekton rekomandimet e Ministrisë së Financave. Kjo është për t'u përshëndetur. Po ashtu është inkurajuese që të hyrat komunale planikohen të rriten nga rreth 42.6 milion sa kanë qenë në vitin 2026 në mbi 48.1 milion euro për vitin 2029. Kjo i bie një rritje prej 13% dhe tregon ambicje dhe shpresojmë që kjo do të shoqërohet edhe me efikasitet më të madh në administrimin e financave publike. Megjithatë suksesi i një komune nuk matet vetëm me rritjen e të hyrave. Ajo matet edhe në mënyrën se si i kthehen këto shërbime në të mira për qytetarin. Për këtë arsye një ndër objektivat kryesore të kësaj kornize është edhe ngritja e kapaciteteve njerëzore, profesionalizmi i administratës dhe përdorimi i teknologjisë. Për mua ky është një nga investimet më të rëndësishme sepse administrata është fytyra e komunës. Qytetari nuk e mat suksesin tonë me dokumente që ne i miratojmë këtu, po me mënyrë me shërbime që i marrin në sportel, me shpejtësinë e përgjigjes dhe me respektin që i ofrohet. Sa i përket projekteve prioritare, për mua ky dokument nuk është vetëm një raport me shifra. Ai është një përditshmëri e jona e përbashkët dhe duhet me reflektuar me nevojat reale të qytetit. Tash janë disa komente në lidhje për drejtori të caktuara dhe shpresoj që këto të merren si kritikë dhe jo si diçka personale. Tek Drejtoria e Mobilitetit mendoj se të gjithë pajtohem se sot lëvizja në Prishtinë është bërë e vështirë dhe shpeshherë e padinjtetshme për qytetarët. Po kjo nuk është përgjegjësi e vetëm e kësaj drejtorie por rezultat i disa politikave të ndjekura ndër vite. Prishtina vazhdon me qenë një ndër kryeqytetet më të varura nga automjetet private në Evropë. Për këtë arsye krahas projektit për ndërtimin e trotuareve të sigurt për këmbësorët do të dëshiroja të shihja edhe investime në pritore moderne të autobusëve me strihimore, ulëse, ndriçim dhe tabela dixhitale informuese e cila bëhet po ashtu me zgjerimin e rrjetit të korsive të biçikletave. Këto janë investime që e bëjnë transportin publik edhe një lëvizje alternative më tërheqëse për qytetarët. Edhe te Drejtoria e Rinisë ka projekte shumë të qëlluara. Rivitalizimi i qendrave rinore është një hap pozitiv sepse energjia krijuese e të rinjve të Prishtinës vazhdon të mbetet një nga asetet më të mëdha të qytetit.

Megjithatë kur papunësia e të rinjve mbetet rreth 41% besoj se ky plan mund të ishte më ambicioz. Një projekt i rëndësishëm do të ishte dhe transformimi i Pallatit të Rinisë duke pasur parasysh se Komuna e Prishtinës është aksionare kryesore dhe tashmë ekzistojnë negociata për sigurimin e fondeve nga Bashkimi Europian. Po ashtu edhe pse subvencionet dhe transferet përbëjnë një pjesë relativisht të vogël të buxhetit komunal, ndikimi i tyre është shumë i madh sesa pesha financiare që zënë. Përmes tyre mbështetet bujqësia, arsimi, kultura, sporti, shëndetësia e shumë iniciativa që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së qytetarëve. Prandaj kjo kategori meriton vëmendje të vazhdueshme. Një sugjerim tjetër është që korniza afatmesme buxhetore të lidhet më qartë me strategjitë zhvillimore të kryeqytetit. Sa më mirë të harmonizohen prioritetet me buxhetin, aq më lehtë do të mbahet realizimi i tyre dhe do të jetë më e madhe përgjegjësia institucionale. Në fund dua të theksoj edhe rëndësinë e konsultimeve publike. Ligji jo që i obligon komunat pas hartimit të kornizës buxhetore të zhvillojnë dëgjime publike me qytetarët dhe mendoj që kjo do të ishte jo vetëm një përmbushje e një detyrimi ligjor, por mundësi reale që qytetarët të ndikojnë në prioritetet e qytetit. Për fund të dashur kolegë, Prishtina ka nevojë për më shumë bashkëpunim dhe më pak polarizim. Ka nevojë për projektet që zgjasin më shumë se sa një mandat dhe për politika që i shërbejnë qytetarit pavarësisht se kush është në pushtet. Për këtë arsye edhe pse kemi sugjerime dhe vërejtjet tona, ne e konsiderojmë këtë dokument një bazë të mirë për ndërtimin e buxhetit të vitit 2027. Si grup i asamblesëve të Partisë Demokratike të Kosovës do ta mbështesim dhe votojmë këtë kornizë afatmesme buxhetore me besim se deri te buxheti final do të reflektohen në propozimet që sot i paraqitëm në inter cilat janë në interes të qytetarëve të Prishtinës. Ju faleminderit.

Kryesuesi: - faleminderit zonja Rçica. Nga radhët e Levizjës Vëtvëndosje Feim Osmani ka kërkuar fjalën.

Feim Osmani: - faleminderit kryesues. Përhëndetje për të gjithë. Sikurse edhe herave të tjera kjo korniza afatmesme buxhetore si dokument strategjik i komunës i cili përcakton kornizën buxhetore për tri vitet e ardhshme nuk është se është paraqitur edhe në këtë dokument të hartuar nga ju si i tillë, sikurse në aspektin e të hyrave ashtu edhe në aspektin e shpenzimeve nuk është plan ambicioz por shumë ma shumë një dokument i cili është përshtatur trendëve pa strategji zhvillimore e pa ambicie fare. Në aspektin e të hyrave për shembull është planifikimi i varur krejtësisht nga grantet qeveritare të cilat për tri vitet e ardhshme domethënë nga viti 2027 deri në vitin 2029 kapin shifrën prej 372 milion euro ose 63% të buxhetit në tërësi. Ndërsa të hyrat vetanake për këtë periudhë trevjeçare nuk shënojnë më shumë se 138 milion euro nëse realizohen si të tilla ose vetëm 37% e gjithë buxhetit të paraparë në kornizën afatmesme. Ky planifikim tregon se kryeqyteti nën drejtimin tuaj po ndjek trendin pa strategji e pa vizion fare. Nëse analizojmë me kujdes mundësitë që i ka komuna e Prishtinës për realizim shumë me ambicion të të hyrave është për t'u habitur se si ky kabinet që qeveris Prishtinën nuk ka plan e as vizion për ta bërë një gjë të tillë. Edhe në aspektin e planifikimit të shpenzimeve gjendja nuk është aspak më e mirë. Madje në aspektin e përgjithshëm zhvillimor të kryeqytetit, një shpenzim i planifikuar në këtë mënyrë është shumë i dëmshëm për vetë kryeqytetin. Nga gjithsej 522 milion sa janë planifikuar shpenzohen brenda periudhës sa përfshin kjo kornizë 311 milion apo 65% e shumës së përgjithshme hyjnë në kategoritë shpenzuese si paga dhe medijtë, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale dhe subvencione transfere e që në aspektin

ekonomik impakti i tyre në zhvillimin apo ngritjen e kualitetit të shërbimeve është shumë i vogël për të mos thënë i pavërejtshëm fare. Ndërsa pjesa kryesore e buxhetit, e cila është paraparë për investime kapitale si kategoria kryesore buxhetore e cila është edhe përcaktuese e zhvillimit të gjithë bartshem të komunës e cila po ashtu ndikon në mirëqenien e banorëve të kryeqytetit është vetëm 35% e buxhetit të tërësishëm apo maksimalisht 210 milion euro e parashikuar apo e planifikuar për tri vite e shprehur në shifrat. Domethënë vetëm 210 milion euro po e përsëris. Kjo pra është pasqyrë e qartë se si vizioni për Prishtinën është reduktuar në një pjesë të premtimeve fiktive të vitit 2021 të cilat vështirë se do të realizohen jo për këto tri vite por edhe për shumë të tjera po t'i keni në dispozicion. Edhe ky planifikim ndonese cilësohet si dokument strategjik, si plan buxhetor, përmban elemente diskriminuese sa i përket raportit të investimeve në zonat rurale duke krahasuar natyrisht me zonat urbane. Pra nga gjithsej 210 milion euro të planifikuara për investime kapitale vetëm 11.8 milion euro janë të paraparë për fshatrat ose diçka më shumë se 5% e shprehur në përqindje të buxhetit të përgjithshëm. Në këtë rast këtë dokument buxhetor assesi nuk mund t'a quajmë dokument strategjik sepse 80% të territorit të Prishtinës e lënë të pazhvilluar ose e dallon nga pjesa tjetër e kryeqytetit. E kur dalim te tabela e projekteve të parapara për financim, i vërtetojmë të gjitha konstatimet e cekura më lart, ngase pjesa më e madhe e tyre janë përsëritje e thatë e premtimeve zgjedhore të para pesë viteve. Një pjesë e mirë e tyre janë vetëm sa për ta marrë një kod buxhetor sepse shumat që janë ndarë për to nuk mjaftojnë as për të filluar fazën e parë të realizimit. Për shembull spitalin e Prishtinës, të cilit i janë ndarë 650.000 euro e shumë të tjera projekte të ngjashme si kjo. Projektet që synojnë të bëhen pjesë e buxheteve të viteve në vazhdim, e cilat bllokojnë krejtësisht nyjen e brendshme të qarkullimit ose mobilitetit, ndërsa nuk është gjetur zgjidhje alternative. Pra një përsëritje e situatës sikur me sheshin “Xhorxh Bush” edhe në rastin e zgjerimit të sheshit deri tek rrethi me flamur i cili si projekt gjendet në planifikim në dokumentin tuaj të quajtur korniza afatmesme buxhetore. Pra të gjithë këto të meta që i ka kjo kornizë buxhetore flasin edhe për kohën në të cilën e keni sjellë për miratim vetëm disa orë para afatit të fundit që e përcakton ligji e që nënkuptohet se është bërë veçse për ta përmbushur pjesën ligjore dhe procedurale, me faktin se korniza afatmesme buxhetore ka ardhur në momentin e fundit dhe nuk ka kohë tashmë për përmirësime të mëtutjeshme dhe me shpresën se në buxhetet e viteve që vijojnë e që janë të përfshira në këtë kornizë afatmesme buxhetore duhet dhe do ta keni kurajon t'i përmirësoni të gjitha vërejtjet tona, ne fundja do ta mbështesim me votë. Për fund kam vetëm disa pyetje sa për sqarim, sepse në tabela se si janë paraqitur natyrisht që ka konfuzion, unë për vete s'i kam kuptuar. Besoj që një pjesë e mirë e anëtarëve të kuvendit nuk i ka kuptuar po ashtu sikurse unë . Për shembull në tri vitet e parapara në kornizë keni paraparë vetëm tre shkolla, njëra nga ato ekzistuese dhe dy çerdhe. Shtrohet pyetja; 1. Pse kaq pak investime në arsim? 2. Çka do të thotë si term financimi i shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve dhe 3. Blerja e një mekanizmi për mbjelljen, transportin dhe vendosjen e drunjëve të mëdhenj dhe fidaneve në vlerë prej 1.1 milion euro. Pyetja që shtrohet këtu është, kujt do t'ia dedikonin? Ndonjërit nga ndërmarrjet apo Prishtina tashmë ka staf specializuar që t'a përdorë këtë mekanizëm e ne nuk e dimë. Faleminderit për vëmendjen.

Kryesuesi: - faleminderit z. Osmani. Nga radhët e AKK-së a dëshiron fjalën dikush? Jo, vazhdojmë. Faleminderit. Lidhja e Prishtinës. Dëshirojm fjalën? Në rregull. PSD Besa dëshiron fjalën.

Besa Shahini: - ky dokument ka nevojë për një, domethënë, diskutim shumë të gjatë. Unë do të ndalem në tri pika të shkurtra për shkak të kohës së shkurt që e kemi. E para, dua ta përsëris edhe njëherë dhe t'a theksoj. Nxënësit e Prishtinës janë katër vite mbrapa bashkëmoshatarëve të tyre nëpër kryeqtetet e tjera. Çfarë do të thotë kjo? Që kur e kryejnë gjimnazin ata nuk janë gati as për universitet, as për treg pune, as për jetë. Pjesërisht kjo është për shkak se kalojnë gjysmën e orarit në shkolla dhe kjo zgjidhet duke ndërtuar më shumë shkolla edhe duke krijuar më shumë çerdhe. Në dokumentin që e keni prezantuar janë paraparë të ndërtohen dy shkolla, liceu i cili domethënë po diskutohet me mbi 10 vite edhe një shkollë tjetër edhe dy çerdhe dhe parashikohen më pak se 2 milion euro për disa anekse në shkollat ekzistuese gjoja se për t'a zgjidhur çështjen e mësimi tërëditor. Ajo që është bërë nga qeverisja e mandatit të kaluar është ky eksperimenti i Jehona Lushakut që gjoja se në pesë shkolla e bën mësimin ditor aty shërbehet edhe një shujt e ngrohtë. Fëmijët e tjerë shkojnë në shkolla me gjysmë orari dhe është një pabarazi e thellë në kryeqtetet mes nxënësve që shkojnë në shkollë këtu dhe në vend se të planifikohet që të ndërtohet numri i nevojshëm i shkollave dhe anekseve ajo definitivisht nuk është bërë. Kështu që i bie që edhe në mandatin, këtë mandat që jemi, por edhe me ia dhënë Përparim Ramës dhe Uran Ismailit edhe pesë mandate të tjera me këtë nivel të investimit në arsim nuk do të zgjidhet kurrë çështja e arsimit në kryeqtetet. Por kjo është pika e dytë. Sheshi absolutisht po i merr paret edhe do të vazhdon të ndërtohet me një zell edhe një entuziazëm që sheshi nuk e meriton, nuk ka qenë prioritet për qytetarët e Prishtinës. U nisin si një farë projekti kurajozë i cili ishte edhe pozitiv se okej po mbyllet një hapësirë në qendër për trafik që të mund të dalin njerëzit dhe të shëtisin, përfundoi në një projekt i cili kushton shumë buxhetit të komunës së Prishtinës 18 milion euro, por i cili në fund po përfundon me një qendër tregtare. Auditori kishte gjetur që për të ndërtu sheshin janë shkelur të gjitha rregullat edhe të prokurimit as nuk janë marrë lejet. Domethënë me një entuziazëm të hatashëm është shtyer përpara çështja e sheshit e cila deri tani duke marrë parasysh që na si qytetarë nuk e përdorim atë shesh sepse është gjëmadh deri tani ka shërbyer vetëm si një vend ku është bërë fushata zgjedhore mes Përparim Ramës edhe Uran Ismailit por sheshi po vazhdon shkollat nuk janë askund. Kur jemi te auditori ata gjithashtu kanë nënvizuar problemin që një pjesë e madhe e buxhetit shkon në përmbaram 45 milion euro. Por një gjetje e rëndësishme që e përmendin ata është që 1/3 e këtij buxheti ose më pak në fakt që shkon në taksat e përmbaruesve është për shkak se nuk janë ndarë rezerva të mjaftueshme që rastet gjyqësore të paguhen nga komuna. Kështu që dëmit direkt që i bëhet buxhetit janë paret që përmbarusi i shtin në xhep diku 12, 13, 15 milion euro ose nuk e di sakt sa janë për gjithë shumën që ekziston. Kan nisur thashethemet edhe ja kanë nisur njerëzit me dyshuar që ato pare po kthehen një pjesë e tyre në xhepat e njerëzve që po keqmenaxhojnë me buxhetin e Komunës së Prishtinës. Edhe ky është një problem shumë i madh. Kështu që me sapo shoh ky dokument, kjo kornizë e buxhetit të afatmesëm po tregon që ky mandat i mes Përparim Ramës dhe Uran Ismailit është thjesht një domethënë një shërbim ndaj miqve biznesmen që kanë interesa të ndryshme në kryeqtetet po definitivisht nuk i shërben qytetarëve të Prishtinës.

Kryesuesi: - faleminderit znj. Shahini. Zoti Zabërgja e ka kërkuar fjalën.

Endrit Zabërgja:- faleminderit kryesues. Përshëndetje qytetarë të kryeqytetit. Përshëndetje kolegë asambleistë dhe ju të nderuar anëtarë të kabinetit ekzekutiv. Faleminderit i veçantë

drejtoreshës për prezantimin dhe përpilimin profesional të dokumentit strategjik një prej dokumenteve më të rëndësishme strategjike siç është korniza afatmesme buxhetore KAB-i si dokument bazik paraqet vizionin mbi të cilin ky ekzekutiv do të vazhdojë punën e vet, andaj uroj kthimin e shifrave në letra në punë në veprat të cilat pastaj do të jenë të matshme dhe do të jemi këtu për të kërkuar llogari për secilin projekt kapital të prezantuar. Ky dokument strategjik natyrisht se për secilin nga ne shihet në perspektiva të ndryshëm duke mbështetur sepse të gjithë ne kemi bindje për sektore të ndryshme dhe në secilin moment duke mos i anashkaluar projekte të rëndësishme sikur ato të investimeve kapitale, arsimit, shëndetësisë, administratës, shërbimeve publike, projekte të cilat janë të domosdoshme. Besoj që ekzekutivi në veçanti me trajtim të veçantë në këto tri vitet e ardhshme duhet t'a ketë rininë jo si një investim kapital, por si një investim njerëzor. Sepse nëse pasuria më e madhe është e Prishtinës është rinia trajtimi institucional i saj është më shumë se politik dhe besoj që i takon të gjithë ekzekutivit t'a kenë detyrë në mënyrë që këtë pasuri ta rivitalizojmë ashtu siç është edhe një prej projekteve këtu. Derisa në këtë frymë urojmë që në të ardhmen të reflektohet për buxhetin e vitit 2027 dhe dokumenteve të tjera strategjike ku prioritetet të jenë të ndara ashtu siç janë edhe qytetarët e Prishtinës. E mbështesim këtë dokument duke i uruar punë të mbarë në realizimin e këtyre projekteve dhe duke i uruar reflektim për të gjitha procedurat të cilat duhet ndjekur për realizimin e tyre. Ju faleminderit.

Kryesuesi: - faleminderit z. Zabërgja. Fiknete Bejta e ka kërkuar fjalën.

Fiknete Bejta: - faleminderit kryesues. Të nderuar nënkryetarë, të nderuar kolegë asambleist, të nderuar drejtorë, të dashur qytetarë. Sot kemi para vetes për të diskutuar dokumentin më të rëndësishëm strategjik të Komunës së Prishtinës, kornizën afatmesme buxhetore 2027-2029. Ky dokument nuk është vetëm një plan financiar, por është vizion i zhvillimit të kryeqytetit për tri vitet e ardhshme. Korniza është hartuar në përputhje me legjislacion në fuqi dhe me udhëzimet e Ministrisë së Financave duke garantuar planifikim të qëndrueshëm dhe disiplinë fiskale. Objektivi i kësaj është që burimet financiare të lidhen drejtpërdrejtë me prioritetet e qytetarëve dhe zhvillimin e komunës. Një tregues shumë pozitiv është rritja e vazhdueshme e buxhetit. Për vitin 2027 planifikohet një buxhet prej 161 milion euro, ndërsa në vitin 2029 ai parashihet të arrijë në 175 milion euro. Kjo tregon besimin institucional në kapacitet e kryeqytetit dhe krijon mundësi më të mëdha për investime dhe shërbime më cilësore për qytetarët. Kjo kornizë reflekton qartë prioritetet e qeverisjes sonë. Janë planifikuar investime të rëndësishme në infrastrukturën rrugore, ndërtimin e çerdheve dhe shkollave, përmirësimin e shërbimeve shëndetësore, zgjerimin e hapësirave të gjelbërta, kulturën, sportin si dhe transformimin dixhital të administratës komunale. Këto nuk janë vetëm projekte në letër siç ju thamë më herët, por investime që ndikojnë direkt në jetën e qytetarëve. Një tjetër element i rëndësishëm është kornizave afatmesme buxhetore. Nuk mbështetet vetëm nga grandet qeveritar, por edhe nga të hyrat vetanake dhe kjo kornizë parasheh një rritje substanciale të të hyrave vetanake përmes përmirësimit të arktimit dhe administrimit financiar. Kjo është dëshmi e një menaxhimi më të përgjegjshëm dhe më të qëndrueshëm të financave komunale. Gjithashtu dokumenti vendos tekst të veçantë në transparencë, dëgjime publike, disiplinim financiar dhe planifikim afatgjatë duke e bërë këtë proces buxhetor më të përgjegjshëm dhe më afër qytetarëve. Natyrisht çdo projekt mund të pasurohet me propozime dhe ide të reja, por

është e rëndësishme të kuptohet se kjo kronizë paraqet bazën mbi të cilën ndërtohet buxheti përfundimtar dhe se ajo do të vazhdojë të plotësohet dhe pas dëgjimeve publike. Në këtë seancë u diskutua dhe për disa ngecje në buxhetin e vitit 2025, por sa për koheçencë duhet të informohen asamblistë të rinj që Komuna e Prishtinës mandatin e kaluar ka funksionuar pa buxhet, të miratuar dhe të alokuar nga qeveria dhe prandaj një mungesë e buxhetit i ka kushtuar komunës dhe buxhetit komunal dhe përmbaruesit normal që i marrin mjetet që janë ndarë prej projekteve të realizuara. Dhe gjithsesi çka nuk planifikohet dhe nuk zotohet me kohë normal që do t'i kushtojë qytetarët të Prishtinës. Prandaj ne duhet të jemi të përgjegjshëm dhe dokumentet strategjike të komunës së Prishtinës do t'i miratojmë në kohë. Faleminderit shumë për përdëgjimin me vëmendje.

Kryesuesi: - faleminderit znj. Bejta. Gëzim Sveçla e ka kërkuar fjalën.

Gëzim Sveçla: - të nderuar kolegë asamblistë, përshëndetje për të gjithë përfaqësues të mediave qytetare të Prishtinës. Në lidhje me dokumentin të cilin po e trajtojmë sot, pajtohem me shumicën e konstatimeve që është dokumenti më i rëndësishëm financiar për periudhën trivjeçare. Ajo çka është e pafalshme dhe e patolerueshme në këtë rast është që një dokument të tillë ne po e trajtojmë disa orë para përfundimit të afatit ligjor kur duhet dorëzuar të njëjtin në Ministrinë e Financave. E për më keq i pranishëm nuk është zyrtari më i lartë financiar i komunës së Prishtinës. Ai që do të duhej që ato të cilat ne sot i planifikojmë dhe i votojmë në këtë dokument t'i realizojnë në praktikë. Pra, mungesa e Përparim Ramës e tregon edhe njëherë papërgjegjësinë që ka ai ndaj vetë Kuvendit komunal si institucioni më i lartë legjislativ në kryeqytet, por në përgjithësi ndaj kryeqytetit dhe kjo papërgjegjësi dhe keqmenaxhim së fundmi u konfirmua dhe nga raporti i auditimit të cilin e pamë këto ditë. Ajo çka pajtohem me kolegën nga Partia Demokratike e Kosovës që tha është një dokument politik dhe kjo politikë dhe ky vizion i këtij ekzekutivi parasheh ndërtimin e tri shkollave dhe dy çerdheve sepse nuk është as politikë as vizioni i tyre arsimimi dhe mirëqenia e fëmijëve. Po natyrisht ajo qysh ka ndodhur vazhdimisht edhe gjatë mandatit të kaluar, betonizimi, privatizimi i aseteve publike dhe keqmenaxhimi financiar. Kur jemi te numrat që i përmban KAB-i duhet treguar qartë se kapaciteti financiar i Prishtinës po rritet nga fondet që ka siguruar qeveria e Republikës së Kosovës dhe kjo përshtatet me atë çka tha dhe drejtoresha. Objektivat e qeverisë përputhen me objektivat e komunës, gjë që në realitet dhe në praktikë kryetari vazhdimisht e thotë ndryshe. E sakta dhe ajo që qëndron është pikërisht kjo çka tha drejtoresha që objektivat janë të njëjta. Kjo dëshmohet fare qartë nëse krahasojmë buxhetin e komunës së Prishtinës për shembull për vitin 2022 kur ka ardh në pushtet Përparim Rama të hyrat vetanake prej atëherë deri më sot janë rritur për 10 milion, 10.8 milion saktësisht. Ndërkohë në të njëjtën periudhë fondet që vijnë nga niveli qendror, grantet qeveritare dhe financimi nga ligji për kryeqytetin janë rritur për rreth 48 milion euro. Buxheti i vitit 2026 është afro 61 milion euro më i madh se buxheti i vitit 2022. Nga kjo rritje e këtij buxheti, nga kjo rritje rreth 61 milion euro, 17% janë rritja nga të hyrat vetanake të komunës, ndërsa rreth 79% vjen nga rritja e granteve dhe fondeve shtesë të siguruara nga niveli qendror. Me fjalë të tjera, gjatë kësaj periudhe komuna e Prishtinës ka siguruar rreth 10.8 milion euro më shumë nga burimet e veta. Ndërsa qeveria e Republikës së Kosovës ka siguruar dhe ka sjellë për Prishtinën mbi 48 milion euro. Pra për çdo 1 euro shtesë që ka siguruar komuna nga të hyrat vetanake, niveli qendror, qeveria e Republikës

së Kosovës i ka sjellë 4.5€ shtesë. Komuna 1 euro, qeveria 4.5€ .Kjo dëshmon që për qeverinë e Republikës së Kosovës natyrisht që prioritet është Prishtina sepse është kryeqyteti ynë, kryeqyteti i gjithë banorëve të saj. Një çështje e cila u përmend gjatë diskutimit këtu ka të bëjë me sheshin “Xhorxh Bush”. Prapë po kthehem te raporti i auditimit. Po besoj të gjithë e keni parë se çka konstaton ky raport për sheshin “Xhorxh Bush”. Ndërkohë qytetarët duhet ta dinë se akoma pa u sqaruar dhe akoma pa u përfunduar procedurat ligjore rreth Xhorxh Bushit, në kornizën e re, atë të cilën po e diskutojmë sot, është planifikuar zgjatja e sheshit deri te rrethi me flamur dhe për këtë qëllim janë ndarë ose janë planifikuar të ndahen 3.5 milion euro për zgjatjen e sheshit deri te rrethi me flamur. Po e përsëris, është për keqardhje që këtu nuk është kryetari Përparim Rama dhe është për keqardhje që kjo kornizë po trajtohet ditën e fundit të afatit ligjor siç është për keqardhje që nuk ka pas deri sot dëgjime publike për këtë kornizë siç kanë pas komuna të tjera ku do të inkorporoheshin dhe do të ishin pjesë e saj edhe kërkesat reale të qytetarëve. Faleminderit.

Kryesuesi: - faleminderit z. Sveçla, Jeta Dida-Bujari ka kërkuar fjalën.

Jeta Dida-Bujari: - i nderuar kryesues, të nderuar kolegë, në kuadër të pikës së parë të rendit të ditës, dëshiroj të ndalem dhe të fokusoj vëmendjen e të gjithëve tek një sektor jetik i cili prek çdo familje në kryeqytet, fusha e arsimit, por edhe ajo e kulturës. Edhe pse në parim shohim rritje të buxhetit të projektuar për drejtorinë e arsimit vit pas viti do të thotë 8.5 milion për 2027 12.35 e 15.9 milion për 2029. Ajo që na shqetëson thellësisht nuk janë numrat të cilat vihen në letër, nuk është burimi i premtimeve të reja, por realizimi i tyre i mangët në terren dhe kaosi me planifikimet tona hapësinore. Të nderuar kolegë, në krye të listës së investimeve kapitale të Drejtorisë së Arsimit për periudhën trevjeçare qëndron një projekt me rëndësi të jashtëzakonshme kulturore dhe edukative ndërtimi i liceut artistik. Ky projekt i dedikohet nxënësve, mësimitdhënësve dhe të ardhmes së shkollës së mesme të lartë “Preng Jakova” në Prishtinë. Një shkollë me emër të madh që ka prodhuar e vazhdon të prodhojë talent që na zbardhin fytyrën anë e mbanë botës dhe që për vite me radhë lëngon nëpër objekte të përkohshme pa kushtet elementare për mësim dhe pa hapësira të dinjitetshme që i përgjigjen specifikave të një shkolle të artit. Por teksa flasim për liceun artistik, nuk mund të ulemi në këtë sallë pa e adresuar edhe një tjetër plagë të hapur të komunitetit tonë artistik, një tjetër shembull të dështimit institucional dhe ligjor, çështjen e Teatrit të Operës dhe Baletit me të ashtuquajturin ishulli urban. Në këtë kuvend në 2023 u morë vendim që hapësira prapa pallatit të rinisë dhe sporteve të ndahej për ndërtimin e Teatrit të Operës dhe Baletit, një projekt i shumë pritur kombëtar që do të jepte më në fund shtëpi të dinjitetshme institucioneve tona elite të artit. Megjithatë, ajo që ndodhi në të vërtetë tregon mungesë të thellë serioziteti në menaxhim. Në një pjesë të po kësaj parcele, ekzekutivi i komunës nisi me pompozitet projektin 6.5 milionësh për ndërtimin e platformës ishulli urban i cili lidhë Arbërinë me pallatin e rinisë me idenë për të lidhur këto dy pjesë të qytetit me hapësira gjerbëruese dhe rekreative. Por çfarë ndodhi? Punimet u ndërpre në menjëherë pas fillimit të tyre dhe arsyeja është sa banale po aq edhe shqetësuese. Komuna u kujtua për leje dhe për procedurat e nevojshme ligjore vetëm pasi futi ekskavatorët në terren. Pasi që pallati i rinisë është i mbrojtur si monument i trashëgimisë kulturore, Inspektorati i Kosovës për mbrojtjen e monumenteve doli në terren dhe ndaloi punimet sepse nuk kishte pëlqim e as miratim nga Instituti i Kosovës për mbrojtjen e

monumenteve. Kjo ndërhyrje e paftuar dhe e bllokuar mbi të njëjtën parcelë jo vetëm që ka lënë projektin e ishullit urban në gjysmë, por rrezikon drejtpërdrejt të cënojë, ngushtojë dhe zvarris edhe vetë projektin madhor të teatrit të operës dhe baletit. Komuniteti artistik ka mbetur sërish peng i përplasjeve ligjore mungesës së planifikimit të mirëfilltë dhe nxitimit për të bërë shfaqje politike para se të kryhen detyrat e shtëpisë. Prandaj sot nga kjo foltore shtroj pyetje që bën çdo prind, çdo nxënës i Prenk Jakovës dhe çdo artist i këtij kryeqyteti. Pse po zvarritet dhe pse ende nuk po fillon ndërtimi i liceut artistik? Si është e mundur që futen zotime financiare milionshe në këtë kornizë për projekte të reja, ndërkohë që ato ekzistuese bllokohen në terren për shkak të shkeljeve procedurale dhe mungesës së lejeve elementare? A bëhet fjalë për mungesë të lokacionit, ngecje të qëllimshme nëpër procedura apo thjesht për mungesë të vullnetit politik për t'i dhënë arsimit vendin që meriton. Nuk mund të lejojmë që premtimet për shkollën “Prenk Jakova” të mbesin vetëm pika boshe për të mbushur faqet e këtij dokumenti. Ndërtimi i hapësirave të artit duhet të jetë prioritet mbi prioritetet, por duke u bazuar në ligj, transparencë dhe planifikim të saktë e jo në improvizime që përfundojnë me shifra të bllokimit nga inspektoratet.

Korniza buxhetore duhet të jetë një mjet i besueshëm planifikimi e jo një listë dëshirash që shtyhet nga viti në vit, ndërsa në terren mbretëron kaosi projektues. Andaj i bëjë thirrje drejtorisë së urbanizmit dhe tërë ekzekutivit të komunës që të na japë sqarime të detajuara dhe afate konkrete se kur do të zgjidhen këto ngarkesa ligjore dhe kur do të hidhen gurët e parë të themelit të shkollës “Prenk Jakova” në Prishtinë. Artistët dhe nxënësit tanë nuk kanë më kohë për të pritur. Faleminderit.

Kryesuesi: - faleminderit zonja Dida, Nexhmije Gjema ka kërkuar fjalën.

Nexhmije Gjema: - a po dëgjohe? Po ju faleminderit, kur jemi te investimet kapitale, po nisëm prej projektit të Xhorxh Bushit të sheshit edhe po më vjen shumë keq që kryetari në këto momente dhe prej fillimit nuk gjendet këtu sepse janë tema që i dedikohen edhe pyetjen ja kisha shtruar kryetarit sepse është edhe kryeideatori i sheshit, ndërtimit të sheshit “Xhorxh Bush” edhe vazhdimësisë së tij të këtij sheshi deri te rrethi me flamur. Pyetja im është kjo, çfarë logjike ka edhe bazuar në çka ka filluar ky projekt? Kur nëse e marrim Londrën prej nga ka ardhur kryetari dhe ka jetuar disa vite në Londër, një qytet me 9.8 milion banorë në Londër i ka 12.000 metra katror shesh po e përsëris me 9.8 milion banorë. Ndërsa Prishtina e regjistruar me 250.000 banorë i ka 60 deri në 70.000 metra katror për momentin. A mundeni veç me justifikim idenë e sheshit, e rritjes, e investimeve, këto miliona që ndahen prej buxhetit? Si justifikohet kur ne po dalim që ne kemi shesh 500 deri në 600 herë më shumë se një metropol i botës, Londra. Si ka logjikë kjo? Edhe plus flasim në vazhdimësinë e sheshit me shkuar deri te rrethi me flamur ndoshta edhe deri në Veternik ku është beneficioni ku jemi duke shkuar ne, ku është projekcioni i kësaj bazuar në çka, mandej kur kthehemi prapë te lista e investimeve kapitale në listën e investimeve kapitale janë planifikuar diku rreth 79 milion euro, megjithatë për asnjërën prej projekteve nuk jepet baza e përlllogaritjes, preventivit, projektit ideor apo zbatues, analiza e koston, faza në të cilën ndodhet projekti.

Po e marr shembull varrezat e kryeqytetit në opinionin publik është prezantuar po edhe promovuar projekti i varrezave të kryeqytetit nga kryetari Përparim Rama i cili ka nënshkruar

para disa muajve këtë projekt me komunitetet fetare. Mirëpo për këto tre vite të ardhshme ky projekt nuk figuron askund, as nuk po dimë domethënë ku u zhduk përnjëherë projekti i cili u nënshkru para disa muajve. Megjithatë në këtë pikë nuk përmendet se për çfarë projekte bëhet fjalë dhe kjo bëhet fjalë vetëm për rikonstruimin e varrezave. Po për të cilat varreza nuk potencohet. Mandej, kontrata në shtëpi 1 milion euro për çdo vit. Kjo na shqetëson gjithashtu se për çfarë analize bëhet nevojë kjo ndarje e buxhetit në shtëpi dhe a është bërë ndonjë analizë dhe sa ka qenë ky shërbim, sa është ofruar nga komuna e viteve të kaluara apo vitit paraprak, vetëm sa me pas na një ide se në çfarë raste emergjente për çfarë bëhet fjalë, për çfarë ndahet ky buxhet. Mandej, personat me nevoja të veçanta parashihen 100.000 euro çdo vit. Kur ne e dimë se në Prishtinë infrastruktura për të gjithë ata që kanë me mundësi të kufizuar nuk është punuar asgjë. Çka janë 100.000 euro dhe në bazu në çka sjellen këto shifra në listën e investimeve kapitale, kisha dëshiruar kryetar nëse ka mundësi vetëm edhe dy minuta me shtu se po e shoh që po kalon sekondat. Gjithashtu isha tu fol domethënë për projektet të cilat në investimet kapitale si spitali, qytetet, nënkallimet e tjera e të tjera asnjëra nuk po e ka domethënë justifikimin, specifikimin, informatën shtesë për të cilat rregullisht ne po kërkojmë sa herë po kemi seanca ose lajmërime seancë informata shtesë të cilat nuk po na sillen për me pas më të qartë se për çfarë, sepse ne ta theksoj dhe të jemi të qartë se nuk jemi kundër miratimit të kornizës afatmesme buxhetore, por përkundrazi e konsiderojmë si një dokument të domosdoshëm për planifikimin financiar. Megjithatë edhe kësaj radhe po përballemi me të njëjtin problem që e kemi ngritur vazhdimisht domethënë mundësinë e transparencës dhe të arsyetimit teknik. Siç mos te përsëris edhe njëherë, domethënë gjithëherë po mungon metodologjia e përlllogarit, analizat mbi të cilat janë bazuar këto shifra, preventivet dhe arsyetimi pse është propozuar ajo shumë për secilin projekt. Prandaj kjo kërkesë e jona është e thjeshtë, sepse kjo do ofronte më shumë transparencë, më shumë argumentim profesional edhe më shumë është mënyrë më e mirë për me siguri secilin qytetar se si paratë publike po shpenzohen edhe do të shpenzohen me përgjegjësi edhe profesionalizëm, ju falenderoj shumë.

Kryesuesi: - faleminderit zonja Gjema, Leonora Shabani ka kërkuar fjalën

Leonora Shabani: - faleminderit kryesues, pyetja ime ishte për kryetarin, po meqënëse s'është ai aty, kjo i drejtohet qeverisjes lokale pse kryetari për tre vitet e ardhshme ka paraparë ndërtimin e vetëm dy çerdheve, si kryeqytet mundemi me pas investime në më shumë çerdhe. Është për t'u habitur se si kryeqyteti planifikon për tre vitet e ardhshme ndërtimin e vetëm dy çerdheve. Gjithashtu është edhe tek Drejtoria e Mirëqenies Sociale dhe Rezidenciale. Këtu flitet për financimin e shtëpive, për mbrojtjen e fëmijëve ku në fakt ne qysh e dimë si qytetarë në Prishtinë nuk kemi shtëpi për mbrojtjen e fëmijëve. Sa e dimë janë vetëm dy familje strehuese, por nuk kemi ndonjë qendër për mbrojtjen e fëmijëve. Atëherë do të ishte mirë që të sqarohen më shumë dhe gjithashtu si kryeqytet të kemi investime më shumë për fëmijët dhe mirëqenien e tyre. Faleminderit.

Kryesuesi: - faleminderit, a dëshion dikush fjalën urdhëro drejtoreshë.

Valbona Makolli: - faleminderit, ju dëgjova të gjithëve me vëmendje. Deshta vetëm një sqarim rreth përputhshmërisë së objekteve objektiva të komunës të kryeqytetit. Kjo është ligj, domethënë e pata fjalën është disiplinë asnjë komunë nuk guxon me tejkaluar qarkoren e përgatitur prej komisionit të granteve të zgjedhur me short nga kryeministri. Domethënë që aty e pata fjalën që ky dokument duhet me u përputh ashtu sipas grantit. Jo që jam kundër apo për, unë jam këtu me kryetarin Rama dhe në kryeqytet, por objektivat e kryeqytetit edhe çdo komunë duhet me u përputh me qarkoren 2027/01, tjetra sa i përket s'po dua me hy në detaje secili e dha mendimin e vet, çka mundemi në buxhet kemi me i përkrah, ju ftoj se 20 deri me 24 do të keni dëgjime buxhetore ditën e 10 korrikut posaçërisht e kam bërë për asambleistë edhe përfaqësues ose lagjet e tyre kërkesat e tyre me i dëgju, ju ftoj të vini ju të gjithë edhe normal me qytetarë të cilët i përfaqësoni që ta bëjmë bashkërisht buxhetin po s'kam qare pa e kthyer këtë kërkesën për çerdhet dhe shkolla. Këtë, Ministria e Arsimit e dini ju fort mirë, qarkore e ka shënuar se ka bërë zvogëlimin e mjeteve për shkolla dhe për çerdhe në bazë të planit të cilat ato na duhet vetëm në kuvend me i gjetë, me i çuar dokumentet për hapësirën ose për tokën, kurse mjetet do të bëhen prej Ministrisë së Arsimit. Kështu që nuk janë mbetur keq, janë në punishte për momentin duke punuar mundet edhe drejtori me i caktuar kohë, mirëpo çerdhet edhe shkollat janë Ministria e Arsimit e bën financimin e tyre, kurse komunat të gjitha komunat në kuadër të saj dhe Komuna e Prishtinës duhet të çojnë lokacione të aprovuara prej Kuvendit, por nuk është që është lënë diçka mangu. Faleminderit. S'po e zgjati më shumë.

Kryesuesi: - a dëshiron dikush fjalën! Urdhëro, zonja Gjema ke shfrytëzuar të drejtën. Kërkoj falje. Po e bëjna për të gjith njësoj, kërkoj falje. Edhe zotri Sveçla, ju kam dhënë nga një minutë nëse nuk e keqpërdoni ju të tjerët nga një minutë. A ka mundësi? Ju lutem. Hajde jo jo, unë po flas. Nuk fola as me emrin as me askënd nuk po e bëjna praktikë. E keni konsumu të drejtën? Po më vjen keq edhe ju Feim, ashtu urdhëro. Po ti ke drejtë është në emër të grupit, ka të drejtë urdhëro Feim.

Feim Osmani: - faleminderit kryesues për fjalën. Edhe pse kisha kërkuar që të ketë debat më shumë, është dokumenti kryesor, strategjik, financiar që komuna duhet t'a ketë kornizë për tre vitet e ardhshme, jo që nuk është problematikë e vogël sa të reduktohet diskutimi vetëm në atë pjesën e rregullores sa i përmban pesë minuta. Sidoqoftë, unë nuk shtrova pyetjen në emër të grupit për së paku tre çështje dhe nuk është se mora përgjigje u dha përgjigje vetëm për atë pjesën e çerdheve edhe të shkollave. Më pëlqej që Qeveria e Kosovës ka shprehur gatishmëri edhe po punon në ndërtimin e çerdheve të shkollave. Mirëpo sepse ankesat kanë qenë të tjera nga eksponent politik natyrisht mirëpo nuk mora përgjigje në disa çështje që janë ndoshta edhe pak a shumë probleme të shprehjes ose të nocioneve çka do të thotë financimi i shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve edhe blerja e një mekanizmi për mbjelljen, transportin dhe vendosjen e drunjëve të mëdhenj dhe fidaneve. Çështja është që kjo pajisje a do të përdoret nga punëtorët e komunës apo do t'i dedikohet ndonjë nga ndërmarrjet se nuk po e kemi të qartë. Kështu që

kisha dasht nga dikush që është kompetent që i ka dërguar këto propozime tek drejtoria e Financave të na i sqarojë se janë iluzion nuk janë të qarta mjaftueshëm, falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit zoti Osmani! Dikush tjetër? Betim Abdullahu ka kërkuar fjalën.

Betim Abdullahu: - përshëndetje, një pyetje kam për drejtoreshjen e investimeve kapitale. Në krejt këtë projektdokument nuk jam duke e pa as fshatin Vranidoll, as Rimanishtë e as Tenezhdoll. Në tri vitet e ardhshme asnjë investim nuk është në këto tri fshatra. Kështu që si të tillë unë si asamblist i asaj zone nuk mund ta votoj.

Kryesuesi:- falemnderit. Dëshiron dikush fjalën? Jo. Atëherë ju lutem regjia të jetë gati për votim. A ka mundësi së pari me konstatu korumin? A ka mundësi me konstatu korumin. 47 janë prezent. Regjia të jetë gati për votim, votojmë tash. Falemnderit. Me 41 vota për, 2 kundër, asnjë abstenim, kalon pika e parë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e radhës. Pika dy, Propozim - vendimi për ndarjen e mjeteve financiare të NPL Prishtina Parking. Për këtë pikë të rendit të ditës, fjalën ia jap nënkryetarit zoti Dushi, fjala për juve nënkryetar.

Florian Dushi: - atëherë falemnderit, e dini që për shkak të vendimit të gjykatës supreme ndryshimeve që detyrimisht jemi fut dhe ndryshimit të Rregullores së Prishtina Parkingut, kjo ndërmarrje që një kohë është ballafaquar me disa probleme financiare, prandaj mbi bazën e kërkesës edhe të ushtruesit të detyrës së kryeshefit aktual keni para vetes një Propozim - vendim për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria e subvencioneve në vlerë rreth 100.000 € ose 100 mij euro më falni. Prandaj do të kisha kërkuar që me mirëkuptimin e të gjithëve të mbështetet ky vendim dhe të aprovohet ndarja e këtyre mjeteve për faktin që derisa të përfundojnë procedurat e ndryshimit dhe aprovimit të rregullores, e cila garanton pastaj një stabilitet financiar dhe të kësaj ndërmarrjeje sikur që e kishte deri para vendimit të Gjykatës Supreme të aprovohet kjo mbështetje financiare për këtë ndërmarrje, falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit nënkryetar, drejtoreshë fjala për juve. Valbona Makolli ka kërkuar fjalën.

Valbona Makolli: - vlera e këtij subvencioni është 100.000 € dhe kategoria ekonomike është subvencione dhe transfere nga administrata. Ajo duhet të përmirësohet prej zyrës së Kuvendit se nuk di a është cek apo jo.

Kryesuesi: - falemnderit drejtoreshë hapi diskutim për këtë pikë të rendit të ditës, ose shkojmë me shefat e grupeve, zoti Pacolli ka fjalën.

Egzon Pacolli: - falemnderit kryesues, ne e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës për subvencionimin e Prishtina Parkingut.

Kryesuesi: - falemnderit zoti Pacolli. Nga radhët e PDK-së. Kush e dëshiron fjalën? Kushtrim, jo, më fal. Trim Sylja ka kërkuar fjalën.

Trim Sylja: - në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, ne e përkrahim subvencionin për Prishtina Parkingun. Ju falemnderit shumë.

Kryesuesi: - falemnderit, Nga radha e Lëvizjes Vetëvendosje, kush e ka kërkuar fjalën? Nora Kelmendi.

Nora Kelmendi: - falemnderit shumë, i nderuar kryesues, të nderuar kolegë asambleistë, i nderuar kabinet, të nderuar përfaqësues të mediave. Më lejoni që në kuadër të përgjegjësisë sonë si këshilltar komunal të ndalem tani në disa mangësi serioze procedurale dhe ligjore të cilat i kemi identifikuar së bashku në vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për këtë ndërmarrje publike lokale. Pas qortimit të këtij dokumenti apo një fletë e cila është dërguar përmes postës elektronike, konstatojmë se ky vendim nuk i plotëson kushtet dhe standardet minimale të arsytimit dhe transparencës që kërkohen për një akt administrativ. Unë sapo e kuptova nga nënkryetari që kemi të bëjmë me subvencion dhe do të ndajmë 100.000 euro. Vendimin të cilin e kemi të gjithë para vetes është i zbrazët dhe këtë në fund do të ndaj të gjithë gazetarëve dhe juve që ta shihni. Pra vendimi fillimisht nuk përmban fare arsyetim, nuk e specifikon qartë qëllimin dhe destinimin e mjeteve që propozohen të ndahen. Në vendim nuk e keni përcaktuar shumën e mjeteve financiare që kërkohen të aprovohen nga ky kuvend komunal, gjë që e bën të pamundur vlerësimin e ndikimit buxhetor të këtij vendimi. Po flas për vendimin të cilin e kemi pranuar të gjithë ne përmes postës elektronike. Në vendim nuk e keni treguar burimin e financimit. Pra nuk e dimë nga cila kategori apo linjë do të mbulohen këto shpenzime. Nuk është e qartë a kemi të bëjmë me subvencion, a kemi të bëjmë me transfer financiar apo ndonjë formë tjetër të mbështetjes financiare. Vendimi për ndarje të mjeteve financiare, siç e dini, duhet të përmbajnë edhe një kërkesë zyrtare të menaxhementit të ndërmarrjes publike lokale me të cilën kërkesë do të arsyetohet ndarja e këtyre mjeteve dhe e cila kërkesë pra nuk është dorëzuar tek ne. Nëse kemi të bëjmë me subvencion atëherë duhet ta kishim pasur edhe kërkesën nga ndërmarrja publike lokale. Përballë këtyre mangësive lind një pyetje e thjeshtë dhe legjitime. A është sjellë ky vendim për shqyrtim pas një analize serioze profesionale dhe ligjore apo po kërkohet nga ky kuvend komunal që të miratojë një vendim pa informacion bazik dhe pa dokumentacionin e nevojshëm. Ju të gjithë e dini që nga ne nuk mund të kërkonim që të votojmë ndarjen e këtyre mjeteve financiare pa arsyetim të plotë, pa shuma konkrete dhe pa dokumentacion i cili e mbështet këtë kërkesë. Le të themi qartë që vendimi që kemi para vetes, përveç se është proceduralisht dhe materialisht i mangët, krijon përshtypjen e

një ndërhyrje financiare që synon të amortizojë pasojat e një keqmenaxhimi të ndërmarrjes, vendimmarrje të gabuar dhe potencialisht në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Kuvendi komunal nuk mund të shndërrohet në mekanizëm për legalizimin e pasojave të vendimeve të gabuara administrative, por përkundrazi e dini që detyra jonë është të kërkojmë përgjegjësi, transparencë dhe respektim të procedurave ligjore. Para se të autorizojmë shpenzimin e këtyre mjeteve financiare, shtrohet pyetja, a do të vazhdojmë edhe më tutje t'i mbulojmë problemet e ndërmarrjeve publike lokale përmes këtyre injektimeve financiare? Sot këtu nga ne kërkojmë që të mbulojmë borxhet e kësaj ndërmarrjeje dhe shtrohet pyetja e thjeshtë. Çfarë borxhe po mbulojmë dhe për çfarë arsye? A janë këto borxhe që rrjedhin nga kontratat për sisteme, për qira apo për obligime që janë krijuar ndërkohë me një bazë juridike të kontestueshme apo mbulojmë borxhe të cilat do të përfundojnë në procedura përmbare, apo ky injektim financiar është thjesht një marifet i radhës i Kryetarit Rama. Prandaj para se të votojmë kemi të drejtë dhe obligim të dimë se a po financojmë një shërbim publik të domosdoshëm për qytetarët apo po mbulojmë pasojat e mungesës së planifikimit dhe menaxhimit joefektiv të ndërmarrjes. Pse keqmenaxhimi i një ndërmarrjeje publike lokale duhet të paguhet nga qytetari pa përgjegjësi, pa reformë dhe pa asnjë auditim? Ne nuk jemi kundër ndërmarrjes, të gjithë e dini, sepse parkingjet janë në interes të qytetarëve, por ato duhet të funksionojnë në baza të qarta ligjore, me menaxhim të përgjegjshëm financiar dhe transparencë të plotë ndaj publikut. Të gjithë e dimë se ju si shumicë mund edhe ta miratoni këtë vendim me votë, por ajo që kërkohet sot nuk është e thjeshtë një shumicë votash, por është një arsyetim i qartë të na vijë dokumentacion i plotë dhe përgjegjësi për mënyrën se si po shpenzohen këto para. Prishtina Parking ka nevojë për reformë, për ristrukturim dhe për një model të qëndrueshëm të funksionimit. Personalisht asnjëherë dhe as sot nuk jam dakort që këtu të votojmë për mbështetje financiare të pakushtëzuar pa i adresuar shkaqet që janë prodhuar nga kjo situatë. Për këtë arsye ne konsiderojmë që çdo ndarje financiare për këtë ndërmarrje duhet të kushtohet së paku me hartimin dhe miratimin e një rregulloreje të re në përputhje me legjislacionin në fuqi, e cila rregullore pas dëgjimeve publike duhet të finalizohet në këtë kuvend. Po flas për rregulloren e cila është dërguar në dëgjim publik dhe nuk e keni sjellë tek ne, kryerjen e një auditimi të pavarur financiar që sqaron mënyrën e krijimit të këtyre obligimeve në mënyrë që të identifikohen përgjegjësitë institucionale, hartimin e një plani konkret të rimëkëmbjes financiare dhe operacionale i cili garanton se situata të tilla nuk do të përsëriten në të ardhmen, duke i dhënë prioritet pagesës së punëtorëve dhe përmbushjes së obligimeve tjera ligjore. Ne kemi detyrim ndaj qytetarëve që çdo ditë paguajnë taksa dhe presin që paratë e tyre të menaxhohen me përgjegjësi. Po ashtu kemi detyrim edhe ndaj punëtorëve që me të drejtë presin pagat dhe sigurinë e tyre në vendin e punës. Pikërisht për këtë arsye nuk mund të votojmë sot për të mbuluar pasojat e problemeve që askush nuk merr përgjegjësi të shpjegojë. Kryetari edhe pse nuk është këtu po i çoj po i them kryetarit që qytetarët e Prishtinës nuk janë votuar që të jenë spektatorë të problemeve të qytetit, por janë votuar që t'i zgjedhin ato probleme. Prishtina e dini që ka nevojë për udhëheqje të mirëfilltë të kryeqytetit dhe ndërmarrjeve publike, jo për arsyetime e justifikime. Arsyetimet tuaja tanë janë bërë rutinë, ndërsa dështimet tuaja janë bërë normë. Prandaj kryetari, nëse po më dëgjon, po i them që ai tani duhet t'i mbledhë plaçkat dhe të ikë, sepse kryeqyteti meriton më shumë. Tani më lejoni që të gjithë gazetarëve t'ju ndaj këtë vendimin të cilin e keni dorëzuar ju para disa ditëve. Le ta shohim që vendimi është i zbrazët, nuk ka shumë financiare dhe nuk ka as arsyetim ligjor dhe

po ashtu nuk ekziston pra nuk ekziston asgjë në të. Nuk e dimë as subvencion apo diçka tjetër. Falemnderit.

Kryesuesi: - a përfundove Norë? Nga radhët e Aleancës, dëshiron fjalën dikush? Jo, Lidhja e Prishtinës.

Teuta Kadiu Gjinolli: - falemnderit kryesues, ndërmarrja dhe punëtorët e Prishtina Parking kanë nevojë për mbështetje dhe ne e mbështesim këtë vendim duke e konsideruar një hap të rëndësishëm për forcimin e ndërmarrjes, përmirësimin e kushteve të punëtorëve dhe vlerësimin e kontributit të tyre të përditshëm në ofrimin e shërbimeve për qytetarët, falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit. Zoti Zabërgja dëshiron fjalën.

Endrit Zabërgja: - Besa njëherë kryesues.

Kryesuesi: - Besa të lutem kërkoj falje, Besa Shahini e ka fjalën.

Besa Shahini: - atëherë unë po e kuptoj nevojën e ndërmarrjes për një subvencionim të tillë. Është e pamundur me votuar këtë vendim në mënyrën qysh ju e keni sjellë me domethënë edhe këtu kur u prezantu thanë rreth 100.000 € euro, ndoshta po e bëj edhe një kërkesë po e përsëris të njëjtën kërkesë që po e bëjmë sa herë po mblidhemi këtu ju lutem dokumentacionin dërgojeni me kohë edhe me arsyetimet e nevojshme përndryshe po është e pamundur me votu edhe për pikat me të cilat po pajtohem me qeverisjen në Prishtinë.

Kryesuesi: - falemnderit zonja Shahini, zoti Zabërgja ka fjalën.

Endrit Zabërgja: - falemnderit Kryesues, e kemi përpara vetes një pikë goxha të domosdoshme? Dorën në zemër ne jemi të zgjedhur të qytetarëve. Përballë e kemi kabinetin ekzekutiv edhe nëse duam të lëmë faje politike kemi me diskutu gjithë ditën. Po ajo për çka ne jemi këtu është me bë zgjidhje dhe me kryer punë. Siç e dini tema e Prishtina Parkingut tash e një kohë përmendet sillet në asamble, kam qenë vetë inicues në të kaluarën edhe të rirregullimit të asaj rregulloreje e cila mandej e ka penalizuar punën e Prishtina Parkingut edhe në realitet çka kemi parë këtu kemi parë që nuk ka pasur vullnet politik me e shty përpara këtë ndërmarrje. Derisa pajtohem me shumë nga parafolësit edhe me kritika, të cilat duhet me u adresu natyrisht unë besoj që është tejet e rëndësishme edhe për qytetarin, por në të njëjtën kohë edhe për

ndërmarrjen. Na ndërmarrjen me pas si diçka tonën edhe duke qenë diçka e jona me shpëtuar prej kësaj krize e cila e ka kapluar tash sa kohë. Ne veç e kemi votuar tashmë procesin për diskutim publik të rregullores së re të Prishtina Parkingut edhe besoj që është e domosdoshme që të paktën një infuzion i tillë t'i jepet kësaj ndërmarrjeje sepse në fund të fundit shërbimet e saj shkojnë për qytetarët e kryeqytetit dhe po ne e mbështesim këtë subvencion duke uruar që tani t'i zgjedhim edhe aksionarët edhe menaxhmenti i ri t'i marrë punët në dorë dhe t'i vazhdojë projektet edhe vizionin e tyre me këtë ndërmarrje, e cila në realitet duhet të jetë një prej ndërmarrjeve më të fuqishme të kryeqytetit. Duhet me potencu që përgjegjësi dhe obligim ligjor është i asamblesë ajo çka ka ndodhur sepse e kemi parë e kemi një situatë krejt të pakëndshme atje me përmbarues ku punëtorët nuk i marrin rrogat e veta etj, etj., edhe besoj që është e domosdoshme besa edhe simbolike kjo shumë e subvencionimit kështu që uroj që ky të jetë fillimi e pastaj mandati të na gjejë me një Prishtina Parking të funksionalizuar. Ju falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit zoti Zabërgja. Zoti Mehmeti nuk deshiron fjalën. Vazhdojmë me Kushtrim Sopën

Kushtrim Sopa: - falemnderit kryesues, falemnderit kolegë të nderuar dhe media ju të pranishëm dhe qytetarë të nderuar. Unë fillimisht kisha nderin dhe privilegjin që isha njëri prej themeluesve të kësaj ndërmarrjeje pra mandatit 2017-2021. Kjo ndërmarrje filloi fillimisht me tre punonjës, ndërsa sot numëron diku afro 200 punonjës. Iniciativa për të dhënë ndihmë nga Komuna e Prishtinës karshi gjendjes aktuale të krijuar pas vendimit të Gjykatës Supreme është iniciativë e qëlluar dhe shumë me vend, mirëpo vlera e kësaj shume nuk mbulon as 70 % të pagës mujore të punonjësve aktual që janë në ndërmarrjen Prishtinë në Parking. Borxhi i akumuluar sipas të dhënave është afro 1 milion euro dhe kryesisht është ndaj operatorëve të cilët Prishtina Parking funksionon, policisë, digjitalizimit, si dhe disa operatorë të tjerë. Sindikata e ndërmarrjes Prishtina Parking është shfaqur tani me kërkesat e veta dhe ato kërkesa janë publike. Ndërsa kisha sugjeruar si Kuvend komunal që bashkërisht pavarësisht petkave politike, të angazhohemi që ta riaktivizojmë në kapacitetet e plota ndërmarrjen Prishtina Parking. Sigurisht duke mbështetur edhe këtë vendimin e fundit që është tanimë në dëgjim publik, por edhe sa më shpejt të inicohet që të votohet edhe rregullorja e re dhe ta shtrijmë kapacitetin dhe operimin në qytet e pse jo mos të bllokohet kjo shifër me 200 punonjës dhe të shtohen edhe më tepër punonjësit në qytetin e Prishtinës. Janë të mirëseardhura vendet e reja të punës. Të shohim pak më gjerë dhe të mendojmë për të ardhmen. Falemnderit shumë të gjithëve, respekt.

Kryesuesi: - falemnderit zoti Sopa. Enver Redenica ka kërkuar fjalën.

Enver Redenica: - falemnderit kryesues Kupina. Përshëndetje kolegë të nderuar, drejtorë të drejtorive dhe ju të pranishëm në këtë sallë. Qytetarë të dashur, sot po bëhen mbi gjashtë muaj apo saktësisht 204 ditë që nga dita kur u betuam ne në këtë sallë si asambleistë se do t'u shërbejmë qytetarëve dhe kryeqytetit tonë ndershmërisht. Mirëpo gjatë kësaj periudhe kryetari

Përparim Rama ka thirr vetëm tri mbledhje të rregullta të Kuvendit komunal. Ka disa komuna të tjera që kanë shkuar deri në nënte mbledhje të rregullta. Të gjitha mbledhjet tjera përfshirë edhe këtu të sotme janë thirrur si mbledhje të jashtëzakonshme duke na pamundësuar neve si asambleistë t'i trajtojmë problemet dhe kërkesat e shumta të qytetarëve që kemi. Sipas vlerësimit tim kjo bëhet me një qëllim të vetëm të shmanget llogaridhënia dhe të vazhdohet me një menaxhim pa transparencë të parasë publike. Sa i përket kësaj pike të NPL Prishtina Parking, ne jemi që të mos lejojmë falimentimin e kësaj ndërmarrjeje dhe që punëtorët e saj bashkë me familjarët e tyre të mos mbeten në rrugë. Por para se të kërkohet subvencionim me para publike është dashur të kemi një raport të detajuar që tregon qartë pse dhe nga kush kjo ndërmarrje publike është sjellë në këtë gjendje në prag të falimentimit ku të gjithë e dimë se kjo duhej të ishte një nga ndërmarrjet më fitimprurëse në Prishtinë. Po flasim për një ndërmarrje që gjeneronte mbi 20.000 euro të hyra në ditë, ndërsa sot kërkohet që nga buxheti i qytetarëve t'i sigurohen mjete. Është për keqardhje që deri në këto momente nuk na treguat ose nuk keni lajmëruar se për çfarë saktë alokohen ato mjete, pagat e punëtorëve, meditet, shujta apo larje të borxheve që kanë të përmbaruesit për rimëkëmbje apo të përfundojnë në xhepat e dikujt tjetër si deri tani, këtu dikush duhet të japë llogari e në veçanti ish-kryeshefi saj Sokol Havolli dhe zoti Rama duhet të jeni përgjegjes pasi për këtë ndërmarrje ka pasur dyshime serioze për keqpërdorimet e parasë publike që ju ka mundësuar vetë zoti Rama. Kush na garanton sot se edhe këto mjete të reja nuk do të përfundojnë dhe në xhepat e dikujt apo nuk keqmenaxhohen si duhet? Mosndëshkimi i tyre që solli Prishtina Parkingun në këtë gjendje është motiv për pasardhësit tjerë në këtë ndërmarrje të vazhdojnë me të njëjtën metodë keqmenaxhoni, vidhni pa problem se në fund faturën do ta paguajë qytetari. Kjo është thjeshtë me thënë plaqkë dhe nuk duhet lejuar më kështu. Ky pastaj subvencionim paraqitet si sukses në rrjetet sociale të Përparim Ramës si në facebookun e tij që po bën filma. E në fakt nuk po shpëtohet ndërmarrja, por po mbulohen pasojat e një keqmenaxhimi me paratë e qytetarëve me mundësi vazhdimi. Prandaj krahas subvencionimit duhet të zhvillohet një hetim i plotë nga prokuroria për shkaqet që e sollën ndërmarrjen në këtë krizë financiare dhe vetëm pas llogaridhënies mund të flasim për ndarjet tjera të mjeteve publike. Qytetarët na kanë votuar për t'i mbuluar qytetarët, nuk na kanë votuar për t'i mbuluar dështimet e askujt e aq më pak të Përparim Ramës. Na kanë zgjedhur të kërkojmë përgjegjësi, të mbrojmë interesin publik dhe të sigurohemi në çdo euro të qytetarëve që shpenzohet me përgjegjësi dhe transparencë të plotë që fatkeqësisht nuk po ndodh, falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit zoti Redenica, Feim Osmani ka kërkuar fjalën.

Feim Osmani: - falemnderit kryesues. Janë dy çështje që më bëjnë të ndihem jashtëzakonisht keq tek kjo çështja e kërkesës për ndihmë financiare për ndërmarrjen Prishtina Parking. E para është që edhe në këtë pikë mungon kryetari, e ne po kemi kërkesa për shumë sqarime të cilat nuk po mundemi t'i marrim nga personi kyç, i cili është fajtori kryesor edhe për gjendjen të cilën ka ardhur ndërmarrja, dhe e dyta është, jo kërkesa për ndihmë financiare por çështja pse ndërmarrja ka ardhur në këtë situatë sa të kërkojë mbështetje nga Komuna e Prishtinës. Një ndërmarrje e cila ka klientelë të garantuar, madje nuk ka çfarëdo klientele, por ka klientelë më tepër sesa që ajo ka kapacitet t'i menaxhojë. Do të thotë një ndërmarrje që kishte mbi 2,000,000

euro qarkullim, në vitin 2024 vjen para falimentimit pa u deklaruar falimentimi fare dhe kërkohet mbështetje financiare sot nga Kuvendi komunal. Kjo është shumë shqetësuese. Kjo është për t'u analizuar se si ka mundur të vijë deri këtu kjo situatë. Është bukur vështirë një ndërmarrje të tillë me e sjellë në këtë situatë pa marrë parasysh çfarë menaxhmenti ka ajo. Edhe po të jetë menaxhmenti më i keq të cilin do ta vendoste një person që nuk ia do të mirën Prishtinës, do të ishte e vështirë të sillej ndërmarrja në këtë situatë që është sot, meqë ndërmarrja kishte performancë jashtëzakonisht të mirë financiare dy vite më parë dhe shtoj faktin këtu se ka më shumë se një vit kur gjykata kompetente ka shpallur vendimin që rregullorja ka qenë jashtë normave ligjore dhe si përgjegjësi që sot kërkon ndihmë financiare për ndërmarrjen nuk e ka sjellë asnjëherë për diskutim në kuvend dhe për të miratuar nenet problematike, të cilat e kishin shfuqizuar ndërmarrjen apo më mirë me thënë rregulloren në të cilën bazohej ndërmarrja. Pra kur kemi pasur mundësi që para një viti të vijë në kuvend e të miratohej rregullorja e ndërmarrja të fillonte të punonte për së mbari dhe sot të ishte profitabile ashtu sikurse do të duhej dhe do të kishte mundësi të ishte, ne sot kërkojmë ndihmë financiare 100.000 euro pa u sqaruar paraprakisht anëtarët e kuvendit ku do të shkojnë ato mjete, pse ka ardhur situata deri këtu dhe pse ka ndryshuar drastikisht kërkesa edhe për financim ngase në raportin që u lexua para jo më shumë se dy ose tre muajve kishte kërkesë tjetër për ndihmë dhe raporti ishte jashtëzakonisht i keq. Në atë raport nuk ishte përshkruar aq sa duhej gjendja në të cilën ndodhet ndërmarrja në vitin 2026. Do duhej këtu para kërkesës për ndihmë financiare të na shpjegohej ku është gjendja sot, çfarë po ndodh sot me ndërmarrjen, sa ka të hyra, si po menaxhohen ato të hyra dhe çka në përgjithësi parashihet të ndodhë me ndërmarrjen në të ardhmen. Kërkesa për mjete financiare 100.000 euro është shqetësuese jashtëzakonisht shumë, mirëpo fakti pse ndërmarrja ka ardhur në këtë situatë është shumë më shqetësuese, shumë më brengosëse dhe ndoshta e pashpresë fare se do të bëhet diçka në këtë aspekt. Unë edhe njëherë kisha kërkuar sqarim nga kompetentët, nuk di tashmë kush do ta bëjë këtë pasi që kryetari nuk është dhe fjala që unë sot e kisha marrë si të mirëqenë në aspektin informativ do të ishte fjala e kryetarit. Kryetari nuk është. Falemnderit shumë.

Kryesuesi: - falemnderit z. Osmani. Drejtoresha Valbona ka kërkuar fjalën.

Valbona Makolli: - kryesues për arsye të problemeve teknike që nuk janë shënuar ato, kërkoj të tërhiqet kjo pikë për mbledhjen e rregullt të radhës.

Kryesuesi: - falemnderit drejtoreshë. Besart Krasniqi ka kërkuar fjalën.

Besart Krasniqi: - në njërën anë menaxhmenti i ndërmarrjes Prishtina Parking, ndërkohë vazhdimisht është krenuar me arritjet dhe sukseset e kësaj ndërmarrjeje, kurse sot po kërkohet subvencionimi në vlerë prej 100.000 euro nga buxheti publik. A mund t'a shpjegoni qytetarëve këtë situatë? Si mund të ndodhë që një ndërmarrje e paraqitur si e suksesshme të ketë nevojë për mbështetje financiare shtesë nëse ndërmarrja po funksionon me sukses nuk arrin të mbulojë shpenzimet dhe investimet nga të hyrat e veta? Cili është efekti dhe qëndrueshmëria e një ndërmarrjeje publike kur ajo mbështetet financiarisht nga Kuvendi komunal jo kryesisht nga aktivitetet e saj ekonomike. Po ashtu për gati dy vite me radhë qytetarët e Prishtinës janë gjobitur e pas Gjykatës Supreme kjo mënyrë e gjobitur konsiderohet e jashtëligjshme. Çfarë do të ndodhë me qytetarët që kanë paguar këto gjoba? A planifikoni t'ua ktheni mjetet që kanë

paguar, kanë bërë pagesën? Sa do të jenë veprimet konkrete me adresimin e kësaj çështjeje? Pse nga zyrat publike keni kaluar në zyrat private dhe në fund meqënëse jemi duke folur për ndërmarrjen Prishtina Parking a planifikohet zgjerimi i veprimtarisë Prishtina Parking dhe në lagje të tjera si: Kodra e Trimave, Kolovicë, Vneshtat, Medresa pasi që a parashihen investimet në ndërtimin e parkingjeve për banorë të këtyre lagjeve duke pasur parasysh nevojën e madhe për hapësira apo parkim. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit Besart. Gëzim Sveçla ka kërkuar fjalën

Gëzim Sveçla: - përshëndetje për të gjithë edhe njëherë. Të nderuar kolegë, unë në fillim të diskutimit e kam veç një pyetje. A njihni ndonjë kompani që e ka monopolin, që s'ka konkurrencë, që i ka klientët e garantuar dhe megjithatë kërkon subvencion nga qytetarët për t'i paguar pagat, qiranë dhe borxhet? Shko merru me Noën, pse s'po merresh me problemet e qytetarëve të Prishtinës. Unë nuk e njoh asnjë. E megjithatë sot pikërisht kjo po na kërkohet me bërë me Prishtina Parkingun. Edhe sot nuk është fjala veç për 100.000 euro që po kërkohen. Sot po duan të vendosim nëse do të shpërblejmë keqmenaxhimin që është ndërtuar me vite apo do të kërkojmë përgjegjësi. Prishtina Parking nuk është një ndërmarrje që konkurren në treg, nuk ka konkurrencë, nuk ka rrezik që dikush me ia marrë klientët, e ka monopolin mbi parkingun publik në kryeqytet, e ka tregun e garantuar. Në këto rrethana një ndërmarrje e tillë nuk do duhej të ishte barrë për buxhetin e komunës, përkundrazi do duhej të ishte një ndërmarrje që kontribuon në buxhet. Megjithatë sot na kërkohen subvencione për paga, për sigurime, për qira të pronave të donatorëve të partisë. Këtë nuk e dimë sepse nëse dështon një ndërmarrje me monopol, problemi nuk është tregu, problemi është menaxhimi. Edhe kjo nuk është rastësi. Ky është model i qeverisjes që Prishtina e ka aplikuar tash e disa vite. Modeli i LDK-së dhe i PDK-së ku ndërmarrjet publike janë shndërruar në vende punësimi politik pa objektiva, pa kontroll dhe pa llogaridhënie. Ndërmarrje publike që ofrojnë tendera dhe kontrata për donatorët e partisë. Ndërmarrje publike që u shërbejnë shokëve si individë, jo shoqërisë si kolektiv. Sot e kemi te Prishtina Parkingun, më herët e kemi pas te pastrimi, te NPB-ja, Sport Marketing, pothuajse në çdo ndërmarrje tjetër komunale. Problemi nuk është Prishtina Parkingun. Problemi është mënyra si janë menaxhuar ndërmarrjet publike në këtë qytet. Problem është mendësia e instaluar në ndërmarrje dhe heshtja e aprovimi i ekzekutivit të Prishtinës përballë këtij fenomeni. Po përveç këtij modeli të dëmshëm dhe të dështuar, ekzistojnë edhe vendime konkrete që kanë bërë këtë kërkesë edhe më të papranueshme. Menaxhmenti ka lëshuar zyrat publike në Pallatin e Rinisë dhe ka marrë me qira zyra private në objektin e donatorit të partisë. Sot po kërkojmë subvencion që qytetarët paguajnë një kosto që vetë ndërmarrja e ka shkaktuar. Edhe kjo nuk është pasojë e mungesës së mjeteve. Kjo është pasojë e vendimeve të këqija menaxheriale dhe heshtjes të komunës përballë këtyre gabimeve. E kemi edhe aktgjykimin e gjykatës supreme tash e sa kohë. Asnjë veprim prej Kuvendit Komunal të Prishtinës. Si opozitë e kemi votuar vendosjen në dëgjim publik. Aty keni ngecur. Asnjë veprim nuk e keni marrë. Është mbajtur dëgjimi publik për Rregulloren për tarifa dhe gjoba. Akoma nuk e keni mbajtur për Prishtina Parkingun. Akoma nuk e keni kthyer ligjshmërinë. Për më tepër ju e keni legalizuar hajninë në Prishtina Parking. Që ku ka letra ku punëtorët e Prishtina Parkingut prezantohen rrejshëm si inspektor komunal, me emër e me mbiemër, me ID të falsifikuara. Drejtor, kjo është vepër penale, prezantimi i rrejshëm, që ku ka komunikim brenda

grupit të punëtorëve dhe menaxherëve të Prishtina Parkingut. Po ju lexoj veç një pjesë të vogël djema. Pasi që këtë muajin që shkoj ka qenë muaji i Ramazanit, është muaji i rahmetit, nuk kemi dashur që të bëjmë shumë presion të panevojshëm te ju. Sipas të hyrave tona në laura, kemi shumë hapësirë ku është keqpërdorur pozita e inkasantit, ku kanë rënë të hyrat. Menaxheri po ju thotë keni vjedhur po Ramazan po ju falim e po vini po lypni pare. Krejt këtu ka ndodhur në sy të aksionarëve të Prishtina Parkingut, në sy të bordit të Prishtina Parkingut, në sy të Përparim Ramës, të kryetarëve të degës së dytë, të gjithëve edhe pastaj keni nevojë, pastaj keni fytyrë me ardhë, me marrë me kërkua taksa të qytetarëve të Prishtinës. Kjo është e turpshme çfarë po ndodh. Kjo është ajo e menaxhimit që ua ofroni Prishtinës, dhe pastaj plus dokumentacionin nuk e sillni në rregull, e sillni me hapësirë pa asnjë arsytim të vetëm, po na duhen 100.000 euro. Për çka po ju duhen 100.000 euro? Për me plotësuar kushtin e PDK-së për me marrë ndërmarrjen a për çka po ju duhen 100.000 euro? Ku është transparenca? Në këtë rast gjashtë muaj ditë tri mbledhje i kemi mbajt, komuna me më së pakti mbledhje në Kosovë jeni. Tani na bllokoi qeveria. Ju ka treguar raporti i auditimit kush iu bllokoi. Këtu nuk po punojnë hetuesia dhe prokuroria, këtu gjysma e ekzekutivit të Prishtinës e kanë vendin tjetërkund, e kanë vendin në burg.

Kryesuesi: - falemnderit z. Sveçla. Bekim Gashi ka kërkuar fjalën.

Bekim Gashi: - falemnderit kryesues. Përshëndetje për të gjithë. Sinqerisht me dëgjuar dikë tjetër kisha thënë është ashtu qysh po thonë, por shikoni raportet Qeveria e Republikës së Kosovës sa ndërmarrje në nivel qendror iu ka ndihmuar. Jo jo Gëzim, Gëzim të lutem. Ju keni vjedhur edhe në magje. Kur them magje keni vjedhur edhe në rezervat shtetërore. Po, po ky po të thotë korrupsion korrupsion. Ata kanë vjedhur në magje, në magje kur them në rezerva shtetërore kanë vjedhur. Ka aktakuzë për këtë punë ku i kanë thënë edhe çite kapelën e hy në zyrë mos me u ditë kush je. A po kupton këtë e kanë bërë? Nuk ka, jo nuk duhet me na shit moral këtu kur një kryeministër i vendit nuk i përgjigjet as drejtësisë e kur një kryeministër e ka shkelë 16 herë Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Jo jo, po jap një shembull. Këta duhet me shku në burg. Sa prej juve është dashtë me shkuar në burg zotni. Sa prej juve është dashtë me shkuar në burg? Ju e dëgjuat propozuesen që kërkoj me tërheq këtë pikë të rendit të ditës. A jemi në rregull, falemnderit

Kryesuesi: - Egzon Pacolli e ka fjalën.

Egzon Pacolli: - ky parafolësi i Lëvizjes Vetëvendosje. Unë jam i LDK-së. E ty nuk të konvenon se të kemi dhënë urdhrat tona si zakonisht.. Më fal të lutem kur flas unë mos dërrhy kur flas unë, qetësohu. Në qoftë se ky zotëria ka fakte, kushdo qoftë ai, ky duhet me çuar në prokurori. Qysh e kemi çuar Faruk Mujkun që ja kanë gjetur 50.000 euro që ka vjedhur ndërmarrjet publike të qeverisë së tij. Qysh ka aktakuzë Faton Peci? Qysh ka aktakuzë për hajni Fitore Pacolli? Ju po na mbani moral në politikë a. Ju jeni hajna klasikë. Nuk ka qeveri pas luftës, të lutem, të lutem kryesues, nuk ka qeveri pas lufte më hajna se ju.

Kryesuesi: - Berita Abazi e ka fjalën. Berita Abazi.

Berita Abazi: - kryesues është shqetësues fakti që në Kuvendin Komunal të Prishtinës që nja 15 minuta është duke u fol për nivelin qendror. Nëse këta kolegët e LDK-së kanë qejf me u

marrë me Albin Kurtin, le të shkojnë, le të zgjedhen deputetë të Kuvendit. Ne kemi zgjedhur me ardh me fol për Prishtinën, për Prishtina Parkingun. Ato që ju dhamin juve shkoni zotëri more merrni vota të hyni në kuvend. Z. Gashi që po merret me çështje të tjera domethënë a mendon diçka përpos interesit personal në anën tjetër e ke gruan tënde o zotëri, çfarë shembulli je ti për qytetarin e Prishtinës, je duke fol për një raport që nuk është duke ditë se nuk ka dokumentacion, pse nuk ka dokumentacion për çka po i japin këto 100.000 euro? Nuk ka dokumentacion. Edhe ti duhesh me qenë i shqetësuar. Po qysh e tërheq pasi u bë gjysma e diskutimit. Po qysh e tërheq? Ku e tërheqi? A ka ndonjë rregullore që funksionon ky kuvend? Nuk mundesh kur të teket ty me heq edhe me fut.

Kryesuesi: - a dëshiron dikush fjalën? Po z. Bekim Bresovci ka fjalën.

Bekim Brestovci: - falemnderit kryesues. Po e shoh të nevojshme me dhënë një sqarim veç për çështjen që e ngriti asambleisti Gëzim Sveçla. Këtu nuk kemi të bëjmë me një falsifikim të emrit. Duhet me e njohur ndoshta si proces. Është inspeksioni ai i cili shqipton gjobat për çfarëdo qoftë shkelje që bëhet në hapësirat e Prishtina Parkingut. Ka një marrëveshje të shkruar në mes të Prishtina Parkingut dhe inspeksionit. Do të thotë Prishtina Parkingu është në njëfarë forme vetëm ai mekanizmi logjistik i cili fillimisht e bën identifikimin e një shkeljeje pastaj e përcjell tek inspektori. Inspektori e miraton gjobën, ia përcjellë në mënyrë digjitale punëtorit të Prishtina Parkingut, i cili pastaj e vë në veturë, i bie në njëfarë forme kështu shumë thjeshtë me e sqaruar sikurse t'ia dërgojmë gjobën me postë dikujt i cili ka bërë shkelje ligjore. Do të thotë që kjo është procedura momentale, po nuk kemi të bëjmë me falsifikim. Kjo është procedura. Inspektor për parkingjet. Falemnderit.

Kryesuesi: z. Sveçla e ka fjalën.

Gëzim Sveçla: - drejtor e kam parasysh procedurën e cila është. Edhe unë veç sigurisht që kërkoj të respektohet procedura e njëjtë në rastin konkret edhe nuk bëhet fjalë për një rast, janë disa prej tyre. Ky personi me emër mbiemër që shkruan këtu nuk është inspektor komunal. A po shiko numrin e ID-së, numri i ID-së 123 123 123, është prezantim i rrejshëm, është vepër penale drejtor. Ka shkruar gjobë kinse e ka miratuar inspektori komunal, nuk e ka bërë inspektori komunal këtë. Ky zyrtari punon në Prishtina Parking. Kështu gjobiten, kështu vidhen qytetarët e Prishtinës. Falemnderit.

Kryesuesi: - Feim Osmani fjalën e ka.

Feim Osmani: - unë u nxita prej sqarimit të drejtorit. Domethënë inspektori nuk del në vend të ngjarjes, nuk e konstaton shkeljen, mirëpo e merr raportin nga punëtori i Prishtina Parkingut pa dalë në terren edhe në mënyrë elektronike ia dërgon gjobën, ai e printon edhe e vendos në veturë, pa qenë inspektori në vendngjarje fare.

Kryesuesi: - falemnderit z. Osmani. Urdhëroni drejtor. z. Brestovci e ka fjalën.

Bekim Brestovci: - kemi dy aktivitete që zhvillojmë: një, dënimet në hapësirat e gjelbëruara edhe parkingjet. Aty i kemi inspektorët, të cilët janë në terren edhe drejtëpërsëdrejti e evidentojnë shkeljen edhe e vendosin gjobën. Ndërsa në hapësirat e Prishtina Parkingut evidentuesit e shkeljeve edhe ata që e vendosin gjobën janë punëtorët e Prishtina Parkingut,

ndërsa miratimi i gjobës bëhet përmes inspektoriatit në formë digjitale. Kjo është procedura e cila është e saktësuar edhe në marrëveshjen e cila ekziston mes Komunës së Prishtinës edhe Prishtina Parkingut.

Kryesuesi: - falemnderit drejtor. A ka dikush tjetër që dëshiron fjalën? Jo. Ju lutem regjia të jetë gati. Konstatojmë së pari kuorumin. 44 janë prezent. Regjia të jetë gati për votim. Votojmë tani. Me 9 vota për, 14 kundër, asnjë abstenim. Nuk kalon kjo pikë e rendit ditës. Vazhdojmë me pikën e radhës. Propozim - vendimi për emërimin e aksionarëve në kompaninë rajonale të mbeturinave “Pastrimi”, SHA. Ndërmarrja publike banesore, SHA. Ndërmarrje publike “Gjelbër”, SHA, ndërmarrje publike “Prishtina Parking”, shoqëri aksionare. Ndërmarrja publike “Sport Marketing”, SHA. Kush do me marrë fjalën? Agnesa Avdyli Vitia nga radhët e PDK-së.

Agnesa Avdyli Vitija: - përshëndetje të nderuar, përshëndetje kryesues, të nderuar nënkryetarë, drejtorë dhe kolegë asamblistë. Më lejoni t'i propozoj emrat e aksionarëve për Ndërmarrjen publike banore, propozojmë aksionaren - Fjolla Vukshinaj Reçica dhe Elmi Fazliun. Për ndërmarrjen Parkingu - Yll Muriqi dhe Muhamed Ademi, për Ndërmarrjen publike lokale “Gjelbër” - Kumrie Shabani Ramadani, si dhe Plator Gërdovci. Për kompaninë rajonale “Pastrimi” - Hana Bajrami Rexhepi dhe Sefedin Sefaj. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit. Rifadije Sopi patët një propozim.

Rifadije Sopi: - falemnderit kryesues. Po e patëm fjalën për një plotësim - ndryshim të ndërmarrja “Sport Marketing”. Është fjala që në vend të z. Driton Rukiqit shkon z. Astrit Gashi. Në vend të z. Pëllumb Bajqinovci shkon Faton Pacolli, e shtuam për shkak se ka ndodhur si gabim teknik që ka mbetur. Po, plotësim - ndryshim. Falemnderit.

Kryesuesi: - falemnderit znj. Sopi. Nuk është pikë kjo veç plotësim - ndryshim ka qenë. Votojmë ne e hedhim në votim. Nëse ka, s'ka. A dëshiron dikush ta marrë fjalën? z. Sveçla e ka fjalën.

Gëzim Sveçla: - fillimisht për këtë propozimin e fundit nuk është pjesë e materialeve që i kemi marrë edhe në seancë të jashtëzakonshme nuk mundet me ndryshuar as pika as emërtimi i rendit të ditës. Është çështje e kryer kjo. Unë po dua aksionarëve të rinj që emërohen sot me iu uruar punë të mbarë. Është e drejtë legjitime e koalicionit që e ka shumicën me i emëruar aksionarët nëpër ndërmarrje. Faktikisht prej balotazhit e kemi ditur edhe kush kanë me qenë aksionarët prej cilit subjekt politik. Uroj që mos të ndodhë ashtu qysh ka ndodhur në mandatin e kaluar, në gjysmë të mandatit me i lënë ndërmarrjet qysh i kanë lënë Partia Demokratike e Kosovës edhe shumica e atyre ndërmarrjeve që një nga një kanë me ardhur tash me kërkuar subvencion janë si pasojë e mungesës të kontrollit nga aksionarët e siç e thashë i ka tërheq Partia Demokratike e Kosovës sepse Besiana nuk është pajtuar me planin për Kalabrinë. Uroj që sa më shumë punë e angazhim në mënyrë që ndërmarrjet t'i shërbejnë qëllimit të vet qytetarëve e asesi të bëhen barrë për Kuvendin komunal.

Kryesuesi: - falemnderit z. Sveçla. A dëshiron dikush fjalën? Jo! Atëherë a po shkojmë krejt po i votojmë bashkë apo një nga një? Paketë. Atëherë falemnderit. Kompania rajonale e

mbeturinave Pastrimi, SHA. propozon Hana Bajrami Rexhepi, Sefedin Sefaj. Ndërmarrja publike banesore SHA. - Fjolla Vukshinaj Reçica edhe Elmi Fazliu. Ndërmarrja publike “Gjelbër” SHA. - Kumrie Shabani Ramadani dhe Plator Gërdovci. Ndërmarrja publike “Prishtina Parking” SHA. - Yll Muriqi, Muhamet Ademi. “Sport Marketing” - Astrit Gashi, Faton Pacolli.

Ju lutem, regjia të jetë gati për votim? Konstatohet njëherë kuorumin, 43. Falemnderit. Ju lutem regjia të jetë gati për votim? Atëherë dy aksionarët e “Sport Marketingut” i shtyejmë për seancën e rregullt. Edhe njëherë ju lutem, po i lexoj emrat. Kompania rajonale e mbeturinave “Pastrimi” - Hana Bajrami Rexhepi, Sefedin Sefaj; Ndërmarrja publike banesore, SHA. - Fjolla Vukshinaj Reçica, Elmi Fazliu; Ndërmarrja publike “Gjelbër” SHA. - Kumrie Shabani Ramadani, Plator Gërdovci dhe Ndërmarrja publike “Prishtina Parking”, SHA. - Yll Muriqi edhe Muhamet Ademi. Ju lutem regjia të jetë gati për votim. Votojmë tani. Me 29 vota për, 1 kundër, asnjë abstenim. Kalon edhe kjo pikë e rendit ditës. Të nderuar kolegë, ju falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin tuaj në këtë mbledhje. Me kaq e konstatoj të mbyllur këtë seancë. Mirupafshim në seancën e radhës!



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d**, të Ligjit nr. 03/ L – 040, për vetëqeverisje lokale, nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010 dhe nenit 17, paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur me _____, merr këtë:

V E N D I M

1. MIRATOHET propozimi për caktimin e Komisionit Vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, Komisioni ka këtë përbërje:
 - Dy anëtarë nga ekzekutivi i Komunës;
 - Dy anëtarë nga Kuvendi i Komunës;
 - Një anëtar nga sektori jo qeveritar.
3. Komisioni vlerësues për shqyrtimin e ofertave, do të punojë në përputhje me Ligjin nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës dhe Rregulloren (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.
4. Administrata e Komunës i ofron përkrahje komisionit sipas kërkesës së tyre.
5. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



RAPORT FINANCIAR BUXHETOR I KOMUNËS SË PRISHTINËS
PËR PERIUDHËN 1 PRILL – 30 QERSHOR 2026 (TM 2)

RAPORTI TREMUJOR ËSHTË PËRGATITUR BAZUAR NË LIGJIN NR. 03/L-048, MBI
MENAXHIMIN E FINANCËVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË

1. Hyrje	3
2. Pasqyra e të hyrave për periudhën prill-qershor 2026 dhe krahasimet me vitet paraprake.....	5
3. Raporti i të hyrave për periudhën prill-qershor 2026, sipas muajve	6
4. Pasqyra e shpenzimeve dhe krahasimet me vitet paraprake	8
5. Pasqyra e shpenzimeve për periudhën prill-qershor 2026.....	9
6. Shpenzimet në projektet kapitale për tremujorin e dytë	10
7. Raporti për pasurinë jofinanciare.....	17
8. Pagesat sipas nenit 39.2 të LMFP-së	18
9. Subvencionet për tremujorin e dytë dhe krahasimi me vitet paraprake.....	18
10. Llogaritë e arkëtuara për vitet 2024, 2025, 2026	19
11. Pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve për vitin 2026 dhe krahasimi me vitet paraprake	19
12. Raporti “Detyrimet kontingjente nga Zyra e përfaqësimit juridik”.....	20
13. Numri faktik i punonjësve të përhershëm dhe të përkohshëm të organizatave buxhetore krahasuar me numrat e autorizuar në buxhet	21
14. Pagesat faktike të interesit ose shumave në natyrën e interesit në borxh, sikur që është paraparë në nenet 50 dhe 51 të këtij ligji, si dhe për pagimin e shumës kapitale të borxhit.....	22
15. Detaje mbi të gjithë përfituesit e granteve publike të bëra gjatë vitit fiskal, si dhe shumat të cilat ata i kanë pranuar	23
16. Detaje të shpenzimeve nga ndarjet buxhetore për shpenzime të jashtëzakonshme, të përshkruara në nenin 29 të këtij ligji	23
17. Detaje mbi të gjitha rregullimet të cilat janë bërë në ndarje buxhetore, në përputhje me nenet 30 dhe 31 të këtij ligji.....	23

1. Hyrje

Raporti i tremujorit të dytë buxhetor, për periudhën prill-qershor 2026, është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët: 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit, nr. 03/L – 048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Raporti i përgatitur nga stafi i Drejtorisë së Financave me autorizimin e Kryetarit të Komunës, mbulon tremujorin e parë të vitit fiskal dhe paraqet informatën e përcaktuar, që ka të bëjë me arkëtimin, shpenzimet dhe të dhënat mbi investimet dhe detyrimet.

Si rezultat, gjithsej të hyrat vetanake të komunës gjatë tremujorit të dytë, kanë shënuar rënie prej 32.95 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo rënie ka qenë kryesisht e shtyrë nga të hyrat e tatimit në pronë (për shkak të vonësave në sistemin e tatimit në pronë e cila është shkaktuar nga MF-ja – DTP), të hyrat nga inspeksioni, taksa për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike, taksa për leje ndërtimore etj.

Ndërkaq, gjithsej pagesat kanë shënuar rritje prej 56.12%, krahasuar me vitin e kaluar, ku kontributin më të madh në këtë rritje gjatë kësaj periudhe e ka dhënë kategoria e mallrave dhe shërbimeve, subvencioneve dhe shpenzime kapitale.

1.1. Performanca e të hyrave

Grumbullimi i të hyrave buxhetore ka vazhduar gjatë këtij tremujori. Të hyrat tatimore dhe jotatimore kanë shënuar një rënie prej 32.95 %, që korrespondon me 4,054,444.01 € më pak krahasuar me tremujorin e vitit paraprak.

Nga kjo performancë e të hyrave në këtë tremujor të vitit 2026, janë grumbulluar të hyra në vlerë prej 8,251,646.16 €.

1.2. Performanca e shpenzimeve

Shpenzimet buxhetore kanë arritur në 45,015,910.79 € përgjatë tremujorit të dytë të vitit 2026, apo 56.12 % më shumë krahasuar me shpenzimet e realizuara gjatë së njëjtës periudhë të vitit paraprak.

- ❖ **Shpenzimet për paga dhe mëditje** gjatë këtij tremujori, shënuan vlerën prej 12,770,961.11 €, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 26.37% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori për këtë periudhë. Fatura e pagave gjatë periudhës raportuese, paraqet një rritje prej 16.06% apo rreth 1,767,285.30€ më shumë krahasuar me faturën e pagave në periudhën e njëjtë të vitit 2025.
- ❖ **Shpenzimet në mallra dhe shërbime** kanë shënuar një rritje prej 34.02% krahasuar me vitin 2025. Gjatë kësaj periudhe vlera e këtyre shpenzimeve ka arritur në 17,130,862.60€. Kjo shumë korrespondon me 44.43% të buxhetit për këtë kategori për periudhën prill-qershor 2026.
- ❖ **Shpenzime në komunalitet**, kanë shënuar një rënie prej 20.88 % krahasuar me vitin 2025. Gjatë kësaj periudhe vlera e këtyre shpenzimeve ka arritur në: 858,497.30 €. Kjo shumë korrespondon me 24.53 % të buxhetit për këtë kategori për periudhën prill-qershor 2026.

- ❖ **Shpenzimet në subvencione dhe transfere**, shënuan vlerën prej 2,142,728.84 € gjatë këtij tremujori, duke arritur kështu normën e ekzekutimit prej 31.51%, krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar të kësaj kategorie për këtë periudhë. Subvencionet dhe transferet, gjatë periudhës raportuese paraqesin një rritje prej 21.30 %, apo rreth 376,271.79 € më shumë krahasuar me subvencionet dhe transferet në periudhën e njëjtë të vitit 2025.
- ❖ **Shpenzimet kapitale** janë ekzekutuar me një normë jo të kënaqshme. Ato arritën vlerën prej 5,713,570.95€, që është 10.69 % e planit gjatë kësaj periudhe të vërtetuar, të cilat kanë regjistruar rënie prej: 1,945,692.00 €, apo një rënie prej 25.40 % krahasuar me shpenzimet në këtë kategori gjatë periudhës së njëjtë të vitit 2025. Duhet të ceket se nga kjo kategori janë ndarë në kategori të veçantë mjetet për vendime gjyqësore dhe përmbarimore në shumë prej: 8,016,283.27 €, nga të cilat janë ekzekutuar pagesa në shumë prej: 6,399,289.99 €.

2. Të hyrat vetanake për tremujorin e dytë të vitit 2026 dhe krahasimi me vitet paraprake


Përshkrimi	2024	2025	2026	Ndryshimi (2025/2026)
	në Euro			
1. GJITHSEJ TË HYRA	9,511,443.97	12,306,090.17	8,251,646.16	67.05%
1.1. Të hyrat nga kodi 17506	3,566,668.98	4,940,904.66	5,017,804.47	101.56%
1.1.1 Tatimi në pronën e paluajtshme	3,334,934.98	4,677,559.32	4,741,361.47	101.36%
1.1.2 Taksa për automjete motorike	231,734.00	263,345.34	276,443.00	104.97%
1.2.Të hyrat nga kodi 16611	22,308.47	32,147.30	29,644.50	92.21%
1.2.1 Të hyra nga inspeksioni	22,308.47	32,147.30	29,644.50	92.21%
1.3.Të hyrat nga kodi 16306	37,137.30	52,890.60	62,009.00	117.24%
1.3.1 Taksa për certifikata dhe dokumente zyrtare	37,137.30	52,865.60	58,195.00	110.08%
1.3.2 Të hyrat tjera: tenderë, kon. tenderi	-	25.00	3,814.00	0.00%
1.4. Të hyrat nga kodi 18166	1,252,469.38	1,066,190.69	318,431.30	29.87%
1.4.1 Taksa për shfrytëzimin e sip. publike	149,582.97	330,560.15	42,253.70	12.78%
1.4.2 Konfiskim i automjeteve	17,694.75	6,602.50	22,263.45	337.20%
1.4.3 Infrastruktura rrugore	593,401.57	353,335.31	276,437.80	78.24%
